Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, e miratuar më 25 Shtator 2015, **“Transformimi i Botës Sonë: Agjenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm”** parasheh që për suksesin e agjendës universale të SDG (ang. Sustainable Development Goals), “të dhëna të zërthyer cilësore, të qasshme, në kohë dhe të besueshme do të nevojiten për të ndihmuar matjen e progresit dhe për të siguruar që askush të mos mbetet pas” (paragrafi 48); pranon se “...të dhënat bazë për disa prej objektivave mbeten të padisponueshme ... “ dhe bën thirrje për: “...forcimin e grumbullimit të të dhënave dhe ngritjen e kapaciteteve në Shtetet Anëtare.”

Një nga sfidat domethënëse me të cilat përballlet Kosova sot është mungesa e të dhënave të përditësuara dhe të besueshme për të informuar vendimmarrjen dhe politikëbërjen e bazuar në dëshmi. Mungesa e të dhënave të zërthyer plotësisht pengon monitorimin e progresit të bërë midis grupeve specifike të popullsisë si minoritetet, vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që preken nga migracioni.

Ky raund i MICS do të plotësojë hendeqet e rëndësishme të të dhënave mbi situatën e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe do të jetë kritik për monitorimin e progresit. Raundi i mëparshëm i MICS me popullatën e përgjithshme dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian i realizuar në Kosovë në vitin 2013–2014 siguroi një burim të përdorur gjerësisht të të dhënave për fëmijët, të cilat ishin thelbësore për të informuar planifikimin kombëtar dhe për të mobilizuar burime për fëmijë.

Zotimi i institucioneve të Kosovës për të avancuar më tej zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të vazhduar përpjekjet drejt zvogëlimit të hendeqeve të barazisë është konfirmuar me miratimin e Rezolutës së SDG (ang. Sustainable Development Goals) nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2018 dhe krijimin e Këshillit të SDG-së për të koordinuar ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e SDG-ve. Të dhënat e MICS 2019–2020 me popullatën e përgjithshme dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian do të informojnë krijimin e agjendës kombëtare të zhvillimit, bazat e SDG-ve dhe monitorimin e progresit.

MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë kanë si objektiv të tyre kryesor:

- Të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë për vlerësimin e situatës së fëmijëve, adoleshentëve, femrave dhe ekonomive familjare në Kosovë;
- Të sigurojnë të dhëna të nevojshme për monitorimin e progresit drejt objektivave kombëtare, si bazë për veprimin në të ardhmen;
- Të grumbullojnë të dhëna të ndara për identifikimin e pabarazive dhe të informojë politikatat që synojnë përfshirjen sociale të atyre që janë më të cenueshëm;
- Të validojnë të dhënat nga burime të tjera dhe rezultatet e intervenimeve të fokusuara;
- Të gjenerojnë të dhëna mbi treguesit kombëtar dhe global të SDG;
- Të gjenerojnë të dhëna ndërkombëtarisht të krahasueshme për vlerësimin e progresit të bërë në fusha të ndryshme, dhe të bëhen përpjekje shtesë në ato fusha që kërkojnë më shumë vëmendje; dhe
- Të gjenerojnë të dhëna për sjelljen dhe qëndrimet që nuk janë të disponueshme nga burime të tjera të të dhënave.

Ky raport paraqet rezultatet e MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Tabelat që paraqesin gjetjet për MICS 2019–2020 në Kosovë kanë tituj të hijezuar me ngjyrë të zezë, ndërsa ato që paraqesin gjetjet e MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë kanë tituj të hijezuar me ngjyrë të kaltër.

Në vijim të Kapitullit 2 mbi metodologjinë e anketës, përfshirë dizajnin dhe implementimin e mostrës, të gjithë treguesit që mbulohen nga anketimi, me përkufizimet e tyre, janë paraqitur në Kapitullin 3, “Treguesit dhe përkufizimet”. Para prezantimit të rezultateve të anketës, të cilat janë të organizuara në kapituj tematikë, mbulimi i mostrës dhe karakteristikat kryesore të respondentëve mbulohen në Kapitullin 4, “Mbulueshmëria e mostrës dhe karakteristikat e respondentëve”.

Duke filluar me Kapitullin 5, të gjitha rezultatet e anketës paraqiten në shtatë kapituj tematikë. Në secilin kapitull, një prezantim i shkurtër i temës dhe përshkrimi i të gjitha tabelave të përfshira në kapitull ndiqen nga tabelat.

Kapitulli 5, “Mbijetesa”, përfshin gjetjet mbi vdekshmërinë nën 5 vjeç.

Kjo pasohet nga Kapitulli 6, “Zhvillimi – Shëndeti riprodhues dhe shëndeti i nënës”, i cili paraqet gjetjet mbi fertilitetin, lindjen e hershme të fëmijëve, kontracepcionin, nevojën e paplotësuar, kujdesin antenatal, kujdesin për lindjen, peshën në lindje, kujdesin pas lindjes dhe përfundon me HIV.

Kapitulli pasues, “Zhvillimi – shëndeti, ushqimi dhe zhvillimi i fëmijëve” paraqet gjetjet mbi imunizimin, përdorimin e energjisë shtëpiake, ushqyerjen e foshnjeve dhe fëmijëve të vegjël, kequshqyerjen dhe zhvillimin në fëmijëri të hershme.

Të mësuarit është tema e Kapitullit 8, ku përfshihen gjetjet e anketës mbi edukimin në fëmijëri të hershme, vijueshmërinë në arsim, përfshirjen atërore në arsimin e fëmijëve dhe shkathhtësitë themelore të të mësuarit.

Kapitulli tjetër, “Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi”, përfshin rezultatet e anketës mbi regjistrimin e lindjeve, disiplinimin e fëmijëve, punën e fëmijëve, martesën e fëmijëve, ndjenjat e sigurisë dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje.

Kapitulli 10, “Jetesa në një mjedis të sigurt dhe të pastër”, mbulon temat e ujit të pijshëm, higjienës dhe higjienës menstruale.

Kapitulli i fundit tematik është mbi barazinë – “Mundësia e barabartë në jetë”, kapitulli paraqet gjetjet mbi një sërë temash të lidhura me barazinë, duke përfshirë funksionimin e fëmijës, transferet sociale, diskriminimin dhe ngacmimet.

Raporti përfundon me shtojca, me informacion të detajuar mbi dizajnin e mostrës, personelin e përfshirë në anketë, vlerësimet e gabimeve të marrjes së mostrave, cilësinë e të dhënave dhe pyetësorët e përdorur.

2 METODOLOGJIA E MOSTRËS

Në vitin 2019–2020, janë kryer dy anketime të MICS në Kosovë duke përdorur dy mostra të ndryshme: njëra ishte MICS 2019–2020 për Kosovë dhe tjetra MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. MICS 2019 për Kosovë është kryer në një mostër përfaqësuese të të gjithë popullsisë së Kosovës. MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është kryer në një mostër përfaqësuese të popullsisë së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që jetojnë në Kosovë. Të dy mostrat dhe karakteristikat e tyre teknike do të përshkruhen veçmas në seksionet përkatëse të raportit.

Elementet e metodologjisë dhe të gjetjeve që janë të zakonshme për të dy anketat paraqiten së bashku.

2.1 DIZAJNI I MOSTRËS

Kosova

Mostra e MICS 2019–2020 për Kosovë u dizajnuar për të ofruar vlerësime për një numër të madh të treguesve mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave në nivel të vendit dhe për zonat urbane dhe rurale. Vendbanimet urbane dhe rurale brenda të shtatë rajoneve (Gjakova, Gjiilan, Mitrovica, Peja, Prizren, Prishtina dhe Ferizaj) janë identifikuar si shtresa (strata) kryesore të mostrimit dhe mostra për ekonomi familjare është përzgjedhur në dy faza. Brenda secilës shtresë, është përzgjedhur në mënyrë sistematike një numër i specifikuar i qarkut regjistruar (QR) të regjistrimit të popullsisë me probabilitet proporcional të madhësisë. Në fazën e parë të mostrimit është përzgjedhur mostra me gjithsej 324 QR në nivel kombëtar. Pasi që është kryer listimi i ekonomive familjare në qarqet regjistruar të përzgjedhura, është kryer një mostër sistematike prej 20 ekonomive familjare në secilin qark regjistruar. Meqenëse mostra nuk është vetëpeshuese, peshat e mostrës përdoren për raportimin e rezultateve të anketës. Madhësia e përgjithshme e mostrës për anketën e MICS 2019–2020 të Kosovës është llogaritur si 6,480 ekonomi familjare.¹ Një përshkrim më i hollësishëm i dizajnit të modelit mund të gjendet në Shtojcën A.1: Dizajni i mostrës për MICS 2019–2020 në Kosovë.

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë

Mostra për MICS 2019–2020 e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është dizajnuar që të sigurojë vlerësime për një numër të madh të treguesve mbi situatën e fëmijëve dhe femrave në nivel të vendit, si dhe për zonat urbane dhe rurale. Njësitë kryesore të marrjes së mostrave (NJKM) të përzgjedhura në fazën e parë ishin QR-e të Regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 që kishin të paktën 10 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Janë përzgjedhur gjithsej 80 QR, nga të cilët 22 QR me 50 ose më shumë ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë përzgjedhur me një probabilitet prej 1, ndërsa 58 QR të mbetura janë përzgjedhur sistematikisht nga pjesa e mbetur e kornizës me probabilitet proporcional me madhësinë. 22 QR-të e vetë-përzgjedhura formuan shtresën (stratën) e parë dhe 58 QR-të e mbetura formuan shtresën e dytë. Përzgjedhja urbane/rurale është kryer nga stratifikimi i nënkuptuar brenda secilës prej dy shtresave kryesore. Pasi është kryer regjistrimi i ekonomisë familjare brenda QR-ve të përzgjedhura për të identifikuar ekonomitë familjare me

¹ Puna në terren është pezulluar me regjistrimin e rastit të parë me COVID-19 në Kosovë. Në atë kohë, janë vizituar të gjitha QR-të e mostruara nga MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Një vlerësim i punës së pezulluar ka treguar se 13 nga QR-të e mostruara nga MICS 2019–2020 i Kosovës dhe 4 nga QR-të e mostruara nga MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë nuk janë përfunduar. Në 14 QR nga MICS 2019–2020 e Kosovës, 48 ekonomi familjare nuk janë kontaktuar dhe intervistat për pyetësorë individualë ishin në pritje për 44 femra, 65 meshkuj, 11 fëmijë nën pesë vjeç dhe 12 fëmijë të moshës 5–17 vjeç, ndërsa në 4 QR nga MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 6 ekonomi familjare nuk ishin kontaktuar dhe intervistat për pyetësorë individualë ishin në pritje për 8 femra, 11 meshkuj, 1 fëmijë nën pesë vjeç dhe 3 fëmijë të moshës 5-17 vjeç. Pas një vlerësimi që vazhdimi nuk do të ndikonte në mënyrë të konsiderueshme në shkallën e përfundimit, u vendos që të përmbylej puna në terren.

komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, është kryer një mostër sistematike prej 20 ekonomive familjare në secilin qark regjistruar të mostrës. Në QR-të me më pak se 20 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptian të gjitha ekonomitë familjare janë kryer për mostrën. Një QR nuk kishte ekonomi familjare Rom, Ashkali ose Egjiptian dhe ishte përjashtuar nga mostra. Madhësia e mostrës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në MICS-in e Kosovës ishte llogaritur si rreth 1.420 ekonomi familjare. Meqenëse mostra nuk është vetëpeshuese, peshat e mostrës përdoren për raportimin e rezultateve të anketës. Një përshkrim më i hollësishëm i dizajnit të mostrës mund të gjendet në Shtojcën A.2: Dizajni i mostrës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019–2020 në MICS-in e Kosovës.

2.2 PYETËSORËT

Gjashtë pyetësorë janë përdorur në anketë: 1) një pyetësor për ekonomitë familjare i cili është përdorur për të mbledhur informata themelore demografike për të gjithë anëtarët e ekonomive familjare *de jure* (banorët e zakonshëm), ekonomitë familjare dhe banesat/shtëpitë; 2) një pyetësor i testimit të cilësisë së ujit i administruar në pesë ekonomi familjare në secilin grupim të mostrës; 3) një pyetësor individual për femra, i administruar në secilën ekonomi familjare për të gjitha femrat e moshës 15–49 vjeçare; 4) një pyetësor individual për meshkuj, i administruar në çdo të dytën ekonomi familjare për të gjithë meshkujt e moshës 15–49 vjeçare; 5) një pyetësor për fëmijët nën 5 vjeç, i administruar tek nënat (apo kujdestarët) për të gjithë fëmijët nën moshën 5 vjeçare që jetojnë në ekonomitë familjare; dhe 6) një pyetësor për fëmijët e moshës 5–17 vjeç, i administruar tek nënat (apo kujdestarët) i një fëmije të zgjedhur rastësisht i moshës 5–17 vjeç që jeton në ekonomi familjare.² Pyetësorët kanë përfshirë modulet në vijim:

Pyetësori i ekonomive familjare	Pyetësori individual për femra / meshkuj	Pyetësori për fëmijët e moshës 5–17 vjeç
Lista e anëtareve të ekonomisë familjare Arsimimi Karakteristikat e ekonomisë familjare Privimi material Transferet sociale Përdorimi i energjisë në ekonomi familjare Uji dhe kanalizimi	Historia e femrës ^[M] Fertiliteti ^[M] /Historia e lindjeve Dëshira për lindjen e fundit Shëndeti i nënës dhe i të porsalindurit Kontrollat shëndetësore post-natale Kontracpcioni Nevoja e paplotësuar Qëndrimet ndaj dhunës në familje ^[M] Viktimizimi ^[M] Martesa/Bashkëjetesa ^[M] Funksionimi i të rriturit ^[M] HIV/SIDA ^[M] Pyetësori individual për meshkuj përfshinë vetëm ato module të shënuara me [M].	Historia e fëmijës Puna e fëmijës Disiplina e fëmijës Funksionimi i fëmijës Përfshirja prindërore Aftësitë themelore të të nxënit
Pyetësori për testimin e cilësisë së ujit		Pyetësori për fëmijët nën 5 vjeç Historia e nën 5 vjeçarve Regjistrimi i lindjes Zhvillimi në fëmijëri të hershme Disiplina e fëmijës Funksionimi i fëmijës Gjdhënia dhe marrja e ushqimeve Imunizimi Antropometria

² Fëmijët e moshës 15–17 vjeç që jetojnë pa nënën e tyre dhe pa kujdestar të identifikuar në ekonomitë familjare janë konsideruar të emancipuar dhe Pyetësori për fëmijët e moshës 5–17 vjeç është administruar direkt tek ata. Ky pyetësor i riformuluar lehtas që përfshin vetëm modulin e Historikut të fëmijëve, Punës së fëmijëve dhe Funksionimit të fëmijëve nuk është kopjuar në Shtojcën E.

Për më tepër, për të gjithë fëmijët e moshës 0–2 vjeç me një pyetësor të plotësuar për Fëmijët nën pesë vjeç, Formulari i pyetësorit për regjistrat e vaksinimit në qendrën shëndetësore, është përdorur për të regjistruar vaksinimet nga regjistrat në qendrat shëndetësore.

Modulet dhe pyetjet specifike të anketës

Modulet dhe pyetjet e mëposhtme, të cilat nuk janë pjesë e pyetësorëve të standardit global të MICS, janë përfshirë bazuar në nevojat kombëtare:

Pyetësori i ekonomisë familjare

- **Karakteristikat e ekonomisë familjare dhe privimi material:** Pyetjet e EU-SILC (Statistikat e Bashkimit Evropian mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës) të përdorura për të vlerësuar shkallën e privimit material janë shtuar në modulin e Karakteristikave të ekonomive familjare në Pyetësorin e ekonomisë familjare dhe si modul i veçantë i Privimit material, me qëllim plotësimin e llogaritjes së indeksit të pasurisë, vlerësimin e privimit material dhe paraqitjen e privimit material si karakteristikë e historikut.

Pyetësori individual për femra

- **Shëndeti i nënës dhe i të porsalindurit:** ky modul përfshiu pyetje specifike të anketës në lidhje me përmbajtjen e kujdesit antenatal (ekografia, matja e peshës, matja e lartësisë së uterusit, analiza e sheqerit në gjak, azhurnimi i librit të shtatzënisë).

Përveç administrimit të pyetësorëve, ekipet e punës në terren i kanë matur peshat dhe gjatësitë e fëmijëve nën 5 vjeç si dhe kanë testuar ujin dhe burimet e ujit të ekonomisë familjare për nivelet e *E. coli*. Detajet dhe gjetjet e këtyre observimeve dhe matjeve janë dhënë në seksionet përkatëse të raportit. Më tej, Pyetësori për fëmijët e moshës 5–17 vjeç përfshinte leximin dhe vlerësimin matematikor për fëmijët e moshës 7–14 vjeç.

Pyetësorët janë bazuar në pyetësorët standardë të MICS6.³ Nga versioni anglisht i modelit MICS6, pyetësorët janë përshtatur dhe përkthyer në gjuhët shqipe dhe serbe dhe janë testuar paraprakisht në komunën e Prishtinës, Graçanicës, Fushë Kosovës dhe Ferizajit gjatë muajit gusht 2019. Bazuar në rezultatet e para-testit, janë bërë modifikime në formulimin dhe përkthimin e pyetësorëve. Një kopje e pyetësorëve MICS për Kosovë 2019–2020 është dhënë në Shtojcën E.

2.3 PROTOKOLLI ETIK

Protokolli i anketës është rishikuar dhe miratuar nga Bordi i Shqyrtimit Institucional i Laboratorit të Medias së Shëndetit (ang. Health Media Lab – HML) gjatë periudhës 28 tetor – 20 nëntor 2019. Protokolli ka përfshirë një Protokoll Mbrojtjeje që përshkruan rreziqet e mundshme gjatë ciklit jetësor të anketës dhe strategjitë e menaxhimit për të zbutur këto.

Për secilin respondent që merr pjesë është marrë miratimi verbal dhe për fëmijët e moshës 15–17 vjeç të intervistuar individualisht, është marrë pëlqimi i të rriturve para miratimit të fëmijës. Të gjithë respondentët janë informuar për natyrën vullnetare të pjesëmarrjes si dhe konfidencialitetin dhe anonimitetin e informacionit. Për më tepër, respondentët janë informuar për të drejtën e tyre për të refuzuar përgjigjen e të gjitha pyetjeve ose të ndonjë pyetjeje specifike, si dhe për ndalimin e intervistës në çdo kohë.

³ Pyetësorët standardë të MICS6 mund të gjenden në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#survey-design>.

Një letër informative për ekonomitë familjare ishte përgatitur dhe shpërndarë nga intervistuesit që përmbante informacion në lidhje me anketën e MICS, përdorimin e informacionit, konfidencialitetin dhe informacionin e kontaktit të ASK-së dhe UNICEF-it.

2.4 METODA E GRUMBULLIMIT TË TË DHËNAVE

Anketat e MICS shfrytëzojnë intervistimin personal të ndihmuar nga kompjuteri (CAPI; ang. Computer-Assisted Personal Interviewing). Aplikacioni për grumbullimin e të dhënave u bazua në programin CPro (Sistemi i procesimit të anketave dhe regjistrimeve të popullsisë), Versioni 6.3, duke përfshirë një platformë të dedikuar për MICS për menaxhimin e të dhënave. Procedurat dhe programet standarde⁴ të zhvilluara në kuadër të programit global MICS janë adaptuar në pyetësorët përfundimtarë të MICS 2019–2020 të Kosovës dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë dhe janë përdorur gjithandej. Aplikacioni CAPI është testuar në komunën e Prishtinës, Graçanicës dhe Fushë Kosovës në zonat rurale dhe urbane dhe komunat Rom, Ashkali dhe Egjiptian gjatë tetorit 2019. Bazuar në rezultatet e testit CAPI, modifikimet janë bërë në pyetësorë dhe aplikacione.

2.5 TRAJNIMI

Trajnimi për punën në terren është realizuar për 31 ditë në periudhën tetor – nëntor 2019. Trajnimi ka përfshirë leksione mbi teknikat e intervistimit dhe përmbajtjen e pyetësorëve dhe intervista simuluese midis të trajnuarve për të fituar praktikë në bërjen e pyetjeve. Pjesëmarrësit së pari përfunduan trajnimin e plotë mbi pyetësorët në letër, pasuar nga trajnimi mbi aplikacionin CAPI. Të trajnuarit kaluan pesë ditë në praktikë në terren dhe një ditë në një anketë pilot të plotë në Komunitatet e Prishtinës, Graçanicës dhe Drenas. Agjenda e trajnimit është bazuar në modelin e agjendës së trajnimit të MICS6.⁵

Matësit kanë pasur trajnim të dedikuar për matjet antropometrike dhe testimin e cilësisë së ujit për një total prej 12 ditësh, përfshirë katër ditë në praktikë në terren dhe pilot anketën.

Mbikëqyrësit në terren ndoqën trajnime shtesë mbi detyrat e mbikëqyrjes dhe përgjegjësit të ekipit.

2.6 PUNA NË TERREN

Të dhënat janë mbledhur nga nëntë ekipe; secili ekip është përbërë nga një intervistues mashkull, tre ose katër intervistuese femra, një vozitës, një matës dhe një mbikëqyrës. Puna në terren ka filluar më 1 dhjetor 2019 dhe është pezulluar më 13 mars 2020, pas regjistrimit të rastit të parë me COVID-19 në Kosovë. Në atë kohë, ishin vizituar të gjitha QR-të e mostruara nga MICS 2019-2020 për Kosovë dhe MICS 2019-2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Pas vlerësimit që vazhdimi nuk do të kishte ndikim të konsiderueshëm në shkallën e përfundimit, u vendos që të përfundohet puna në terren.

Të dhënat janë grumbulluar duke përdorur kompjuterë tabletë që përdorin sistemin operativ Windows 10, duke përdorur një aplikacion Bluetooth për operacionet në terren, duke mundësuar transferimin e detyrave dhe pyetësorëve të kompletuar midis tabletëve të mbikëqyrësit dhe intervistuesit.

⁴ Aplikacioni standard për grumbullimin e të dhënave MICS6 mund të gjendet në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#data-processing>.

⁵ Modeli i axhendës së trajnimit mund të gjendet në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#survey-design>.

2.7 MASAT E KONTROLLIT TË CILËSISË TË PUNËS NË TERREN

Mbikëqyrësit e ekipit ishin përgjegjës për monitorimin e përditshëm të punës në terren. Janë kryer vëzhgime të përditshme të aftësive dhe performancës së intervistuesit.

Megjithëse kërkohej një kontroll në terren për secilin grupim, sipas rekomandimit janë kryer tre kontrolle para mbylljes së grupimit.

Gjatë periudhës së punës në terren, secili ekip është vizituar disa herë nga ASK-ja, ekipi i MICS – përkatësisht eksperti i mostrimit, koordinatori i punës në terren dhe metodologët e anketës dhe anëtarët e ekipit MICS të UNICEF, si Konsulenti Kombëtar për MICS, Konsulentët e MICS në terren, Asistenti Administrativ i MICS dhe pikat fokale të MICS. Qëllimi i vizitave ishte kontrolli i cilësisë së mbledhjes së të dhënave, zgjidhja e pyetjeve të menjëhershme metodologjike dhe adresimi i çdo çështjeje teknike. Përveç kësaj, është krijuar një grup në WhatsApp për komunikim të vazhdueshëm me ekipet e punës në terren. Gjatë punës në terren, tabelat e kontrollit në terren (TKT) dhe grafikët e performancës së intervistuesve janë gjeneruar çdo javë për analiza dhe veprime me ekipet në terren. TKT ishin versione të përshtatura të tabelave standarde të prodhuara nga Programi i MICS.⁶

2.8 MENAXHIMI, EDITIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat u morën në ASK përmes sistemit të transmetimit të skedarëve në internet (ang. Internet File Streaming System – IFSS) të integruar në aplikacionin e menaxhimit në tabletët e mbikëqyrësve. Kurdoherë që ishte i mundur në aspektin logjistik, sinkronizimi ishte i përditshëm. Zyra qendrore u komunikonte përditësimet e aplikacioneve ekipeve në terren përmes këtij sistemi.

Gjatë grumbullimit të të dhënave dhe pas përfundimit të punës në terren, të dhënat u edituan sipas procesit të editimit të përshkruar në detaje në Udhëzuesin për Editimin Sekondar, një version i përshtatur i dokumentacionit standard të MICS6.⁷

Të dhënat janë analizuar duke përdorur softuerin Paketa Statistikore për Shkencat Sociale (ang. Statistical Package for Social Sciences – SPSS), Versioni 24. Sintaksa e modelit dhe plani i tabelimit i zhvilluar nga UNICEF janë përshtatur dhe përdorur për këtë qëllim.⁸

2.9 NDARJA E TË DHËNAVE

Identifikuesit unikë si vendndodhja dhe emrat e mbledhura gjatë intervistave janë hequr nga grupet e të dhënave për të siguruar privatësinë. Këta skedarë të anonimizuar të të dhënave bëhen të disponueshëm në faqen e internetit⁹ të MICS dhe mund të shkarkohen lirshëm për qëllime kërkimore legjitime. Përdoruesve u kërkohet të paraqesin kërkimin përfundimtar tek entitetet e regjistruara në skedarin *ReadMe*, vetëm për qëllime informimi.

⁶ Tabelat standarde të kontrollit në terren mund të gjenden në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#data-collection>.

⁷ Udhëzuesi standard mund të gjendet në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#data-processing>.

⁸ Plan i standard i tabelimit dhe skedarët sintaksë mund të gjenden në: “MICS6 TOOLS” Home – UNICEF MICS. Qasur më 23 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#analysis>

⁹ Grupi i të dhënave mund të gjendet në: “Surveys” Home – UNICEF MICS. Qasur më 24 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/surveys>.

2.10 STRUKTURA E RAPORTIT

Ky raport paraqet gjetjet nga MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Megjithëse janë dy anketa të pavarura, vendimi është marrë për t'i paraqitur gjetjet në një raport të përbashkët për ta lehtësuar përdorimin dhe krahasimin e të dhënave.

Çdo kapitull fillon me një hyrje të përbashkët. Pas kësaj, ka shpjegime që i referohen përkatësisht MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Në mënyrë që të diferencohen vizualisht gjetjet që vijnë nga dy anketat, titujt e tabelave nga MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë hijezuar në një ngjyrë tjetër.

2.11 SI TË LEXOHEM TABELAT

KARAKTERISTIKAT E HISTORIKUT

Arsimimi

Kur arsimimi përdoret si karakteristikë e historikut në tabela, nivelet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë përcaktohen në përputhje me klasifikimin aktual të sistemit arsimor të Kosovës (pesë klasë të shkollës fillore, katër klasë të shkollës së mesme të ulët dhe tri klasë të shkollës së mesme të lartë).

Gjetjet për kategorinë e arsimit “të lartë” brenda MICS-it 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian bazohen kryesisht në më pak se 25 raste të papeshuara, dhe janë shumë të pakta për t'i paraqitur ato veçmas. Prandaj, kategoria “e lartë” është kombinuar me kategorinë “e mesme e lartë” dhe është paraqitur si “e mesme e lartë ose e lartë”.

Grupmoshat

Grupmoshat e paraqitura në këtë raport përfshijnë gjithashtu ata persona që kishin mbushur moshën e plotë të paraqitur nga kufiri i sipërm për një grupmoshë, për shembull, respondentët e moshës 15–49 vjeç përfshijnë personat që kishin mbushur 49 vjeç, ndërsa grupmosha e fëmijëve të moshës 20–23 muaj përfshin ata që kishin mbushur plot 23 muaj.

Përkatësia etnike

Për tabelat e MICS 2019–2020 për Kosovë, përveç të dhënave për kategori “Shqiptar” dhe “Serb”, të dhënat për kategoritë etnike janë të kombinuara në “Grupe të tjera etnike” për shkak të numrit të ulët të rasteve të papeshuara. Numrat e rasteve për kategoritë individuale janë paraqitur në Tabelat SR.3.1, SR.5.1W, SR.5.1M, SR.5.2 dhe SR.5.3.

Vështirësitë funksionale

Të dhënat mbi vështirësitë funksionale janë grumbulluar për femrat dhe meshkujt e moshës 15–49 vjeç dhe fëmijët e moshës 2–17 vjeç. Sidoqoftë, karakteristikat e historikut “Vështirësitë funksionale (mosha 18–49 vjeç)”, “Vështirësitë funksionale të nënës” dhe “Vështirësitë funksionale të fëmijës” nuk janë paraqitur në shumë prej tabelave për shkak të numrit të vogël të rasteve të papeshuara për kategorinë “Ka vështirësi funksionale”. Numri total i rasteve është paraqitur në tabelat SR.5.1W, SR.5.1M, SR.5.2, SR.5.3, SR.5.1WR, SR.5.1MR, SR.5.2R dhe SR.5.3R.

Indeksi i pasurisë

Emëruesit për kuintilët e indeksit të pasurisë janë shpesh shumë të vogla për të paraqitur gjetjet sipas kuintilit në tabelat e MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Për të lejuar prezantimin e të dhënave sipas statusit të pasurisë, të dhënat bashkohen në dy grupe – 60 përqind më të varfërit (tre kuintilët e poshtëm të pasurisë) dhe 40 përqind më të pasurit (dy kuintilët e epërm të pasurisë).

SHENJAT E PËRDORURA NË TABELA

Tabelat përmbajnë gjithashtu shenja të veçanta që përdoren vazhdimisht për të treguar si vijon:

- (*) — fusnota në tabela tregon se përqindja ose proporcioni bazohet në më pak se 25 raste të papeshuara dhe për këtë arsye është hequr
- (numër) — shifra në kllapa tregon se përqindja ose proporcioni bazohet në 25 deri në 49 raste jo të matura dhe duhet të trajtohet me kujdes
- “—” — për rastet kur emëruesi është 0
- “W” dhe “M” – shkronjat “W” dhe “M” pas numrit të tabelës tregojnë se i referohet përkatësisht popullsisë femërore ose mashkullore
- R — shkronja R pas numrit të tabelës tregon se i referohet mostrës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

3 TREGUESIT DHE PËRKUFIZIMET

TREGUESI MICS	SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përkufizimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë	
MBULIMI I MOSTRËS DHE KARAKTERISTIKAT E RESPONDENTËVE						
SR.1	Qasja në rrymë elektrike	7.1.1	HC	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me qasje në rrymë elektrike	100,0	99,6
SR.2	Shkalla e shkrim-leximit (mosha 15–24 vjeç)		WB	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15–24 vjeç që janë në gjendje të lexojnë një deklaratë të shkurtër dhe të thjeshtë për jetën e përditshme ose që kanë ndjekur arsimin e mesëm ose të lartë Femrat Meshkujt	99,2 99,4	84,0 89,0
SR.5	Ekonomitë familjare që kanë televizor		HC	Përqindja e ekonomive familjare që kanë televizor	98,9	96,1
SR.6	Ekonomitë familjare që kanë telefon ¹³		HC	Përqindja e ekonomive familjare që kanë telefon (linjë fikse ose telefon celular)	99,4	94,6

¹⁰ Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), <http://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/>. Grupi Punues ndër-institucional për treguesit SDG është duke përditësuar vazhdimisht metadatat e shumë treguesve SDG dhe po bëhen ndryshime në listën e treguesve SDG. MICS mbulon shumë indikatorë SDG me përputhje të saktë të përkufizimeve të tyre, ndërsa disa tregues janë mbuluar vetëm pjesërisht nga MICS. Rastet e fundit përfshihen këtu për sa kohë që metodologjia aktuale ndërkombëtare lejon vetëm mënyrën e përcaktimit të treguesit MICS, dhe ose një pjesë e rëndësishme e treguesit SDG mund të gjenerohet nga treguesi MICS. Për më shumë informacion mbi metadatat e treguesve SDG, shih <http://unstats.un.org/sdgs/metadata/>

¹¹ Disa indikatorë janë formuar duke përdorur pyetje në disa module në pyetësorët e MICS. Në raste të tilla, tregohet vetëm moduli(et) që përmbajnë shumicën e informacionit të nevojshëm.

¹² Të gjithë treguesit e MICS janë ose mund të zërthehen, kur është e nevojshme, sipas kuintilëve të pasurisë, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit migrator, aftësisë së kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike (sipas fushave raportuese), ose karakteristikave të tjera, siç rekomandohet nga Grupi i Ekspertëve ndër-institucional në treguesit e SDG-ve: <http://unstats.un.org/sdgs/indicators/Official%20List%20of%20Proposed%20SDG%20Indicators.pdf>

¹³ Në MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ky tregues llogaritet vetëm duke përdorur të dhënat e mbledhura në Pyetësorin e ekonomive familjare.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përkufizimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
SR.7	Ekonomitë familjare që kanë kompjuter		HC	Përqindja e ekonomive familjare që kanë kompjuter	53,4	23,8
SR.8	Ekonomitë familjare me internet		HC	Përqindja e ekonomive familjare që kanë qasje në internet nga cilado pajisje nga shtëpia	94,5	86,8
SR.18	Modalitetet e jetesës së fëmijëve		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0–17 vjeç që nuk jetojnë me asnjërin prind biologjik	0,7	2,5
SR.19	Prevalenca e fëmijëve që kanë njërin apo të dy prindërit e vdekur		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0–17 vjeç me njërin ose të dy prindërit biologjikë të vdekur	2,1	3,5
SR.20	Fëmijët me së paku njërin prind që jeton jashtë vendit		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0–17 vjeç me të paktën njërin prind biologjik që jeton jashtë vendit	5,2	1,9

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
MBIJETESA¹⁴						
CS.1	Shkalla e vdekshmërisë neonatale	3.2.2	BH	Probabiliteti i vdekjes brenda muajit të parë të jetës	11	21
CS.2	Shkalla e vdekshmërisë post-neonatale		BH	Ndryshimi në mes të shkallëve të vdekshmërisë së foshnjave dhe vdekshmërisë neonatale	4	5
CS.3	Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve		CM / BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së parë	15	26
CS.4	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve		BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet ditëlindjes së parë dhe të pestë	1	2
CS.5	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën pesë vjeçare	3.2.1	CM / BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së pestë	16	27

¹⁴ Treguesit e vdekshmërisë llogariten për periudhën e fundit 5-vjeçare.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
ZHVILLIMI – SHËNDETI RIPRODHUES DHE I SHËNDETI I NËNËS						
TM.1	Shkalla e lindjeve tek adoleshentët	3.7.2	CM / BH	Shkalla e fertilitetit specifik për moshën për femrat e moshës 15–19 vjeç	13	78
TM.2	Lindja e fëmijëve në moshë të hershme		CM / BH	Përqindja e femrave të moshës 20–24 vjeç që kanë pasur lindje të gjallë para moshës 18 vjeç	1,9	16,4
TM.3	Shkalla e prevalencës kontrceptive		CP	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç aktualisht të martuara ose në bashkëjetesë që përdorin (ose partneri i së cilës përdor) metoda kontrceptive (moderne ose tradicionale)	66,7	62,1
TM.4	Nevoja për planifikim familjar e plotësuar me kontracepcionin modern ¹⁵	3.7.1 dhe 3.8.1	UN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç aktualisht të martuara ose në bashkëjetesë që i kanë të plotësuar nevojat e tyre për planifikim familjar me metoda moderne kontrceptive	12,5	17,1
TM.5a TM.5b TM.5c	Mbulueshmëria e kujdesit shëndetësor antenatal	3.8.1	MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç me një lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilat gjatë shtatzënisë së lindjes më të fundit të gjallë ishin kontrolluar (a) të paktën një herë nga stafi i kualifikuar shëndetësor (b) të paktën katër herë nga cilido ofrues (c) të paktën tetë herë nga cilido ofrues	99,7 94,4 63,9	98,0 76,7 37,0
TM.6	Përmbajtja e kujdesit antenatal		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me një lindje të gjallë në 2 vitet e fundit të cilat gjatë shtatzënisë së lindjes më të fundit të gjallë, të paktën një herë, kanë matur shtypjen e gjakut dhe kanë dhënë mostra të urinës dhe gjakut si pjesë e kujdesit antenatal	84,0	74,0
TM.8	Lindjet në institucione		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, lindja e gjallë e fundit e të cilave është bërë në institucion shëndetësor	99,0	98,6

¹⁵ Shikoni Tabelat TM.3.3 dhe TM.3.3R për përshkrim të hollësishëm

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TM.9	Ndihmës i kualifikuar në lindje	3.1.2	MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, lindja më e fundit e të cilave është asistuar nga personeli i kualifikuar shëndetësor	99,5	99,0
TM.10	Prerja cezariane		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, lindja më e fundit e të cilave është kryer me prerje cezariane	31,4	20,5
TM.11	Foshnjat e peshuara në lindje		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, ku fëmija më i fundit i lindur i gjallë është peshuar në lindje	99,5	96,9
TM.12	Qëndrimi në institucionin shëndetësor pas lindjes		PN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit dhe që lindjen më të fundit të gjallë e kanë bërë në institucion shëndetësor, të cilat kanë qëndruar në institucionin shëndetësor për 12 orë ose më shumë pas lindjes	98,2	97,6
TM.13	Kontrolli shëndetësor pas lindjes për të porsalindurin		PN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, fëmija më i fundit i lindur i gjallë i të cilëve ka pasur kontroll shëndetësor gjatë qëndrimit në institucion ose në shtëpi pas lindjes, ose vizitë të kujdesit pas lindjes brenda 2 ditëve pas lindjes	97,7	97,4
TM.14	Tharja e të porsalindurve		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, fëmija më i fundit i lindur i gjallë i të cilëve është tharë (fshirë) pas lindjes	85,1	80,5
TM.15	Kujdesi lëkurë me lëkurë		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, fëmija më i fundit i lindur i gjallë i të cilëve është vendosur në gjoksin e zhveshur të nënës pas lindjes (është dhënë kontakti lëkurë me lëkurë)	32,0	33,2
TM.16	Larja me vonesë		MN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, fëmija më i fundit i lindur i gjallë i të cilëve është larë për herë të parë më shumë se 24 orë pas lindjes	88,5	84,3

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TM.19	Funksionet e kujdesit të sinjalit pas lindjes ¹⁶		PN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, fëmija më i fundit i lindur gjallë i të cilave ka marrë të paktën 2 funksione të kujdesit të sinjalit pas lindjes brenda 2 ditëve të lindjes	93,2	90,1
TM.20	Kontrolli shëndetësor pas lindjes për nënën		PN	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit që kanë pasur kontroll shëndetësor ndërsa ishin në institucion ose në shtëpi pas lindjes, ose vizitë të kujdesit pas lindjes brenda 2 ditëve pas lindjes së tyre më të fundit të gjallë	91,1	86,3
TM.29	Njohuritë gjithëpërfshirëse rreth parandalimit të HIV-it tek të rinjtë		HA	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15–24 vjeç të cilët identifikojnë saktë dy mënyrat e parandalimit të transmetimit seksual të HIV ¹⁷ , të cilët e dinë se personat në dukje të shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv dhe që hedhin poshtë dy keqkuptimet më të zakonshme në lidhje me transmetimin e HIV Femrat Meshkujt	10,5 10,1	2,7 5,8
TM.30	Njohuritë rreth bartjes së HIV-it nga nëna tek fëmija		HA	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15–49 vjeç të cilët identifikojnë saktë të tri mënyrat ¹⁸ e transmetimit të HIV nga nëna tek fëmija Femrat Meshkujt	32,1 22,9	16,5 15,2

¹⁶ Funksionet e sinjalit janë 1) Kontrolli i kordonit, 2) Këshillimi për shenjat e rrezikut, 3) Vlerësimi i temperaturës, 4) Vëzhgimi / këshillimi për ushqyerjen me gji dhe 5) Peshimi i foshnjës (kur është e zbatueshme).

¹⁷ Përdorimi i prezervativëve dhe kufizimi i seksit tek një partner besnik, i pa infektuar

¹⁸ Transmetimi gjatë shtatëzënisës, gjatë lindjes dhe gji dhënies

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TM.31	Qëndrimet diskriminuese ndaj personave që jetojnë me HIV		HA	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15–49 vjeçare që raportojnë të kenë dëgjuar për HIV e që raportojnë qëndrime diskriminuese ¹⁹ ndaj njerëzve që jetojnë me HIV Femrat Meshkujt	78,9 77,8	86,5 85,6

¹⁹ Respondentët që i janë përgjigjur jo njëres prej dy pyetjeve vijuese: 1) A do të blini perime të freskëta nga një shitës ose shitës nëse e dini se ky person ka HIV? 2) A mendoni se fëmijët që jetojnë me HIV duhet të jenë në gjendje të ndjekin shkollën me fëmijë që janë HIV negativë?

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
ZHVILLIMI – SHËNDETI, USHQIMI DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE						
TC.1	Mbulueshmëria me imunizim kundër tuberkulozit		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë vaksinë që përmban BCG në cilëndo kohë para anketës	99,3	99,0
TC.2	Mbulueshmëria me imunizim kundër poliomielitit		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës së poliomielitit joaktiv (IPV) ²⁰ në cilëndo kohë para anketës	90,0	58,0
TC.3	Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, pertusisit dhe tetanusit (DPT)	3.b.1 dhe 3.8.1	IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës që përmban DPT (DPT3) në cilëndo kohë para anketës	90,3	57,4
TC.4	Mbulueshmëria me imunizim kundër hepatitit B		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë të dozën e dytë/të tretë ²¹ të vaksinës që përmban hepatit B (HepB3) në cilëndo kohë para anketës	81,0	50,9
TC.5	Mbulueshmëria me imunizim kundër <i>Haemophilus influenzae</i> e tipit b (Hib)		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës që përmban Hib (Hib3) në cilëndo kohë para anketës	88,4	55,6
TC.8	Mbulueshmëria me imunizim kundër rubeolës		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–35 muaj që kanë marrë vaksinë që përmban rubeolën në cilëndo kohë para anketës	91,4	71,7

²⁰ Vakina e poliomielitit joaktiv (IPV) është administruar në Kosovë që nga viti 2016, megjithatë, grupi mund të përfshijë disa raste të fëmijëve që kanë marrë vaksinën e poliomielitit oral (OPV).

²¹ Treguesi MICS TC.4 mbi mbulimin e përfunduar të imunizimit HepB përfshin fëmijë të vaksinuar sipas orarit të Kosovës me doza 0, 1, 2 dhe 3 dhe sipas orarit serb me doza 0, 1 dhe 2.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.S1	Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit ²²	3.b.1	IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–35 muaj që kanë vaksinat e para kundër fruthit në cilëndo kohë para anketës	91,4	71,7
TC.11a TC.11b	Mbulueshmëria e imunizimit të plotë ²³		IM	Përqindja e fëmijëve që në moshën (a) 24–35 muaj kanë marrë të gjitha vaksinat themelore në cilëndo kohë para anketës (b) 24–35 muaj kanë marrë të gjitha vaksinat e rekomanduara në kalendarin kombëtar të imunizimit	88,1 72,5	59,2 37,5
TC.15	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologjitë për gatim		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me mbështetje primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologjitë për gatim (që jetojnë në ekonomi familjare që raportuan gatim)	33,8	7,9
TC.16	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për ngrohjen e hapësirës		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me mbështetje primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për ngrohjen e hapësirës (që jetojnë në ekonomi familjare që raportuan përdorimin e ngrohjes së hapësirës)	25,9	2,8
TC.17	Mbështetja primare në lëndë djegëse dhe teknologji të pastra për ndriçim		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me mbështetje primare në lëndë djegëse dhe teknologji të pastra për ndriçim (që jetojnë në ekonomi familjare që raportuan përdorimin e ndriçimit)	99,5	98,9

²² Në Kosovë, vakcina e fruthit administrohet si pjesë e vaksinës kundër fruthit, shyta dhe rubeola (MMR) dhe kjo vaksinë u jepet fëmijëve në moshën 12 muajsh ose më vonë.

²³ Vaksinat themelore përfshijnë: BCG, Polio3, DPT3 me 12 muaj dhe 1 dozë të vaksinimit kundër fruthit deri në moshën 24 muajsh. Të gjitha vaksinat përfshijnë: BCG, OPV / IPVr, DPT, imunizimi i përfunduar HepB, Hib3 dhe MMR sipas vaksinimeve të rekomanduara për fëmijët nën moshën 3 vjeç në oraret e zbatuara në Kosovë. Shikoni Seksionin 7.1 për informacion mbi treguesit e imunizimit.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.18	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim	7.1.2	EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me mbështetje primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje të hapësirës dhe ndriçim ²⁴	20,2	1,5
TC.30	Fëmijë të ushqyer me gji ndonjëherë		MN	Përqindja e fëmijëve më të fundit të lindur nga femrat me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilët janë ushqyer me gji ndonjëherë	94,5	96,0
TC.31	Fillimi i hershëm i të ushqyerit me gji		MN	Përqindja e fëmijëve më të fundit të lindur nga femrat me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilët janë vendosur në gji brenda një ore pas lindjes	32,1	54,9
TC.32	Të ushqyerit vetëm me gji nën 6 muaj		BD	Përqindja e foshnjave nën moshën 6 muajsh që ushqehen vetëm me gji ²⁵	29,2	17,0
TC.33	Të ushqyerit me gji si ushqimi kryesor nën 6 muaj		BD	Përqindja e foshnjave nën moshën 6 muajsh që kanë marrë qumështin e gjirit si burim kryesor të ushqimit ²⁶ gjatë ditës paraprake	44,7	39,9
TC.34	Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 1 vit		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–15 muajsh që kanë marrë qumësht gjiri gjatë ditës paraprake	43,8	72,8
TC.35	Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 2 vite		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 20–23 muajsh që kanë marrë qumësht gjiri gjatë ditës paraprake	33,5	(55,4)

²⁴ Anëtarët e ekonomive familjare që jetojnë në familje që nuk raportojnë gatim, pa ngrohje hapësire ose pa ndriçim nuk përjashtohen nga numëruesi

²⁵ Foshnjat që marrin qumësht gjiri dhe nuk marrin lëngje ose ushqime të tjera, me përjashtim të solucionit oral të rehidrimit, vitaminave, shtojcave minerale dhe ilaçeve

²⁶ Foshnjat që marrin qumësht gjiri dhe lëngje të caktuara (ujë dhe pije me bazë ujore, lëng frutash, lëngje rituale, solucion oral për rehidrim, pika, vitamina, minerale dhe ilaçe), por nuk marrin asgjë tjetër (në veçanti, qumësht jo-njerëzor dhe lëngje me bazë ushqimore)

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.36	Kohëzgjatja e gjidhënies		BD	Mosha në muaj kur 50 përqind e fëmijëve të moshës 0–35 muajsh nuk kanë marrë qumësht gjiri gjatë ditës paraprake	12,8	22,8
TC.37	Të ushqyerit me gji i përshtatshëm për moshën		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 0–23 muajsh të ushqyer në mënyrë të përshtatshme ²⁷ gjatë ditës paraprake	42,6	56,8
TC.38	Fillimi me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta		BD	Përqindja e foshnjave të moshës 6–8 muajsh që kanë marrë ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta gjatë ditës paraprake	97,8	(92,4)
TC.39a TC.39b	Ushqyeshmëria minimale e pranueshme		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–23 muajsh që kanë pasur të paktën shumëllojshmërinë minimale ushqyese dhe shpeshtësinë minimale të shujtave gjatë ditës paraprake (a) fëmijë të ushqyer me gji (b) fëmijë që nuk ushqehen me gji	37,4 30,2	22,5 7,7
TC.40	Shpeshtësia e të ushqyerit me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji		BD	Përqindja e fëmijëve që nuk ushqehen me gji, të moshës 6–23 muajsh, që janë ushqyer të paktën 2 herë me qumësht gjatë ditës paraprake	76,0	51,3
TC.41	Llojlojshmëria minimale e ushqimit		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–23 muajsh që kanë marrë ushqime nga 5 ose më shumë grupe ushqimore ²⁸ gjatë ditës paraprake	44,5	21,3

²⁷ Foshnjat e moshës 0–5 muajsh që ushqehen vetëm me gji dhe fëmijët e moshës 6–23 muaj që ushqehen me gji dhe hanë ushqime të forta, gjysmë të forta ose të buta

²⁸ Treguesi bazohet në konsumimin e çdo sasive ushqimi nga të paktën 5 nga 8 grupet e mëposhtme të ushqimit: 1) qumësht gjiri, 2) drithëra, rrënjë dhe zhardhokë, 3) bishtajore dhe arra, 4) produkte qumështi (qumësht, formulë për fëmijë), kos, djathë, 5) ushqime me mish (mish, peshk, mish pul dhe mish mëlçie/ organesh), 6) vezë, 7) fruta dhe perime të pasura me vitaminë A dhe 8) fruta dhe perime të tjera.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.42	Shpeshtësia minimale e shujtave		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–23 muajsh që kanë marrë numrin minimal të shujtave ose më shumë me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta (plus ushqimi me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji) ²⁹ gjatë ditës paraprake	78,7	68,3
TC.43	Ushqimi me biberon/shishe		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 0–23 muajsh që janë ushqyer me biberon/shishe gjatë ditës paraprake	69,3	73,0
TC.44a TC.44b	Prevalenca e nën-peshës ³⁰		AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që bien nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për moshën e standardit të OBSH-së	1,7 0,2	7,1 1,3
TC.45a TC.45b	Prevalenca e ngecjes në rritje ³⁰	2.2.1	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që bien më nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) nën minus tri devijime standarde (e rëndë) të gjatësisë mesatare për moshën e standardit të OBSH-së	4,0 0,9	14,6 3,9
TC.46a TC.46b	Prevalenca e peshës së vogël për gjatësinë ³⁰	2.2.2	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që bien nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për gjatësi të standardit të OBSH	2,3 0,5	2,6 0,5
TC.47a TC.47b	Prevalenca e mbipeshës ³⁰	2.2.2	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që kanë mbi (a) dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për gjatësinë e standardit OBSH	5,9 1,1	2,8 0,7

²⁹ Fëmijët që ushqehen me gji: Ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta, dy herë për foshnjat e moshës 6–8 muajsh dhe tre herë për fëmijët 9–23 muaj; Fëmijët që nuk ushqehen me gji: Ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta ose ushqimit me qumësht, katër herë për fëmijët e moshës 6–23 muajsh.

³⁰ Për shkak të përqindjes së lartë të fëmijëve të përjashtuar nga analiza e treguesve të ushqimit për shkak të matjeve që nuk janë bërë, rekomandohet që gjetjet për MICS 2019–2020 për Kosovë të interpretohen me kujdes. Shih pjesën 7.4 për më shumë detaje.

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.49a TC.49b TC.49c	Stimulimi i hershëm dhe kujdesi i përgjegjshëm		EC	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–59 muajsh të angazhuar në katër ose më shumë aktivitete për të siguruar stimulim të hershëm dhe kujdes të përgjegjshëm në 3 ditët e fundit me (a) Cilindo anëtar të rritur të ekonomisë familjare (b) Babanë (c) Nënë	63,2 10,1 46,4	36,5 5,4 20,9
TC.50	Disponueshmëria e librave të fëmijëve		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që kanë tre ose më shumë libra për fëmijë	27,3	4,0
TC.51	Disponueshmëria e lojërave të fëmijëve		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që luajnë me dy ose më shumë lloje lodrash	61,3	50,4
TC.52	Mbikëqyrja jo adekuate		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç të lënë vetëm ose nën mbikëqyrjen e një fëmije tjetër më të ri se 10 vjeç për më shumë se një orë të paktën një herë në javën e fundit	6,7	8,7
TC.53	Indeksi i zhvillimit të hershëm të fëmijës	4.2.1	EC	Përqindja e fëmijëve të moshës 36–59 muaj që janë në rrugën e duhur zhvillimore në të paktën tri nga katër fushat e mëposhtme: shkrim-lexim/numërim, fizike, social-emocional dhe të mësuarit	91,3	81,8
() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara						

TREGUESI MICS		SDG ¹⁰	Moduli ¹¹	Përshkrimi ¹²	Kosova	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TË MËSUARIT						
LN.1	Vijueshmëria e edukimit në fëmijëri të hershme		UB	Përqindja e fëmijëve të moshës 36–59 muaj që vijnë në një program arsimor të fëmijërisë së hershme	15,0	7,6
LN.2	Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (e adaptuar)	4.2.2	ED	Përqindja e fëmijëve në grupmoshën përkatëse (një vit para moshës zyrtare e regjistrimit në shkollë fillore) që ndjekin një program arsimor të fëmijërisë së hershme ose shkollën fillore	83,8	44,9
LN.3	Përgatitja për shkollë		ED	Përqindja e fëmijëve që vijnë në klasën e parë të shkollës fillore të cilët ndoqën programin e edukimit në fëmijëri të hershme gjatë vitit të kaluar shkollor	87,7	73,0
Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjar që jetojnë në ekonomi familjare të privuara në dimensione të ndryshme, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2019–2020

	Anëtarër e ekonomive familjare që jetojnë në ekonomi familjare që nuk mund të përballojnë artikujt e ndryshëm										Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën tri dimensione ¹	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën katër dimensione ²	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën pesë dimensione ³	Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
	Të paguaj faurën e qirasë, hipotekës apo shërbimeve	Mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate	Të përballoj shpenzimet e papritura	Të ushqehet rregullisht me mish dhe proteina	Të shkoj për pushime	Një televizor	Makinë për larje e rrobave	Makinë, kamion ose furgon	Telefon (fiks dhe celular)					
Totali	69,2	56,7	84,2	71,4	88,7	2,9	11,6	62,5	2,9	86,2	75,6	58,3	7.039	
Vendbanimi														
Urban	66,3	58,6	83,9	69,4	87,9	3,4	9,2	62,6	2,1	84,8	74,2	58,0	3.786	
Rural	72,5	54,5	84,5	73,7	89,7	2,3	14,4	62,4	3,8	87,8	77,2	58,6	3.252	
Të paktën një fëmijë të moshës <5 vjeç														
Ekonomia familjare pa fëmijë <5 vjeç	64,0	50,7	82,0	67,9	87,1	2,2	8,1	59,1	2,3	82,1	70,8	51,2	3.032	
Ekonomia familjare me të paktën një fëmijë të moshës <5 vjeç	73,1	61,2	85,9	74,0	90,0	3,4	14,3	65,1	3,3	89,3	79,2	63,6	4.007	
Numri i fëmijëve <5 vjeç në ekonominë familjare														
0	64,0	50,7	82,0	67,9	87,1	2,2	8,1	59,1	2,3	82,1	70,8	51,2	3.032	
1	75,2	59,6	86,4	75,6	89,5	4,4	12,7	63,3	4,6	89,0	80,1	65,3	2.204	
2	69,1	65,2	87,0	77,9	90,2	1,9	15,1	75,3	1,1	92,0	81,5	65,8	1.212	
3+	73,5	59,5	81,5	60,0	91,5	3,0	18,5	51,1	3,1	84,7	71,0	52,9	590	
Të paktën një fëmijë të moshës <18 vjeç														
Ekonomia familjare pa fëmijë <18 vjeç	58,2	49,2	78,2	62,8	79,3	2,9	9,5	58,3	4,6	75,9	68,9	46,9	757	
Ekonomia familjare me të paktën një fëmijë të moshës <18 vjeç	70,5	57,6	84,9	72,4	89,9	2,9	11,9	63,0	2,7	87,4	76,4	59,7	6.282	
Numri i fëmijëve <18 vjeç në ekonominë familjare														
0	58,2	49,2	78,2	62,8	79,3	2,9	9,5	58,3	4,6	75,9	68,9	46,9	757	
1	64,7	47,3	81,8	65,1	83,7	3,2	10,8	57,5	1,0	81,3	64,9	50,3	778	
2	64,3	56,6	82,5	67,4	86,2	2,9	11,3	58,4	1,9	83,2	70,7	52,8	1.233	
3+	73,4	59,8	86,2	75,2	92,0	2,9	12,2	65,4	3,2	89,8	80,1	63,3	4.271	
Të paktën një adoleshent të moshës 10–19 vjeç														
Ekonomia familjare pa adoleshent të moshës 10–19 vjeç	67,0	55,6	82,9	69,8	85,4	2,6	14,5	63,5	4,1	84,5	74,3	55,6	2.101	
Ekonomia familjare me të paktën një adoleshent të moshës 10–19 vjeç	70,1	57,2	84,7	72,1	90,2	3,0	10,4	62,1	2,4	86,9	76,1	59,4	4.938	

Tabela EQ.5.2R: Privimi material

Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjar që jetojnë në ekonomi familjare të privuara në dimensione të ndryshme, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2019–2020

	Anëtarër e ekonomive familjare që jetojnë në ekonomi familjare që nuk mund të përballojnë artikujt e ndryshëm										Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën tri dimensione ¹	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën katër dimensione ²	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që jetojnë në familje të privuara në të paktën pesë dimensione ³	Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
	Të paguaj faurën e qirasë, hipotekës apo shërbimeve	Mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate	Të përballoj shpenzimet e papritura	Të ushqehet rregullisht me mish dhe proteina	Të shkoj për pushime	Një televizor	Makinë për larje e rrobave	Makinë, kamion ose furgon	Telefon (fiks dhe celular)					
Arsimimi i kryefamiljarit														
Nuk ka arsimim	75,6	60,5	88,3	76,3	91,2	2,9	18,4	73,8	8,4	92,0	82,0	70,6	1.073	
Fillor	70,7	60,3	92,2	78,6	95,6	3,8	14,5	71,6	4,4	93,8	85,8	65,8	1.348	
I mesëm i ulët	70,6	60,1	84,1	72,6	89,1	3,1	10,2	59,9	1,2	86,4	76,8	58,2	3.229	
I mesëm i lartë ose i lartë	59,7	41,8	72,9	57,1	79,1	1,6	6,0	50,3	1,0	73,3	57,4	41,3	1.335	
ND/Mungon	54,4	55,0	84,7	75,5	80,6	0,0	24,7	68,8	5,6	84,7	68,8	49,7	55	
Grupi etnik i kryefamiljarit														
Rom	72,4	54,1	81,9	69,0	85,6	1,8	15,3	66,5	4,4	85,3	75,0	59,0	1.287	
Ashkali	67,7	60,6	88,3	71,8	91,8	2,6	11,9	64,8	3,3	89,5	78,5	60,1	3.464	
Egjiptian	71,1	51,6	79,8	72,2	86,8	3,5	10,2	55,4	1,6	82,1	70,0	55,6	1.774	
Shqiptar	66,1	54,4	78,9	75,7	83,7	5,6	5,3	60,7	0,4	82,3	78,6	55,1	480	
Grupe tjera etnike	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	12	
Mungon	(49,1)	(62,8)	(62,8)	(8,7)	(62,8)	(0,0)	(8,7)	(83,5)	(0,0)	(62,8)	(62,8)	(37,2)	23	
Kuintilët e indeksit të pasurisë														
Më të varfërit	87,0	75,5	98,2	95,3	98,9	7,4	40,9	90,1	13,2	99,7	99,2	92,4	1.408	
Të dytët	82,2	67,5	97,9	88,6	96,6	5,6	13,1	89,1	0,8	99,7	97,0	87,6	1.405	
Mesatarët	74,7	69,3	89,8	82,5	96,0	0,3	2,1	71,7	0,3	97,8	92,8	70,2	1.410	
Të katërtit	64,2	48,6	88,5	62,5	93,2	1,3	1,6	48,3	0,3	93,3	70,5	36,8	1.408	
Më të pasurit	37,8	22,5	46,6	28,0	59,0	0,0	0,4	13,4	0,0	40,3	18,4	4,4	1.408	
Indeksi i pasurisë														
Më të varfërit 60 përqind	81,3	70,8	95,3	88,8	97,2	4,4	18,7	83,6	4,7	99,1	96,3	83,4	4.223	
Më të pasurit 40 përqind	51,0	35,6	67,6	45,3	76,1	0,6	1,0	30,8	0,1	66,8	44,4	20,6	2.816	

¹ Treguesi MICS EQ.S2 – Shkalla e privimit material

² Treguesi MICS EQ.S3 – Shkalla e rëndë e privimit material

³ Treguesi MICS EQ.S4 – Shkalla ekstreme e privimit material

() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela EQ.5.3R: Probleme me vendbanimin dhe mjedisin

Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare sipas problemeve me banesë/shtëpi dhe mjedisin në të cilin jetojnë, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2019–2020

	Probleme me banesë/shtëpi			Probleme që lidhen me vendin ku jeton ekonomia familjare			Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
	Një çati që rrjedh	Lagështi në mure, dysheme ose themele	Dëmtime në kornizat e dritareve ose dysheme	Zhurme ¹	Mjedis	Krim	
Totali	39,6	69,5	51,0	19,0	47,5	10,9	7.039
Vendbanimi							
Urban	37,8	66,2	46,4	24,9	51,9	13,4	3.786
Rural	41,6	73,3	56,4	12,0	42,4	7,9	3.252
Arsimimi i kryefamiljarit							
Nuk ka arsimim	42,4	75,5	65,1	15,7	47,1	15,7	1.073
Fillor	45,3	72,7	59,7	18,4	48,7	10,7	1.348
I mesëm i ulët	40,0	72,1	50,0	19,3	47,1	9,4	3.229
I mesëm i lartë ose i lartë	30,8	55,1	33,0	21,3	47,7	10,5	1.335
ND/Mungon	32,1	69,5	58,8	20,1	50,3	14,7	55
Grupi etnik i kryefamiljarit							
Rom	41,3	66,8	52,3	24,2	50,8	18,8	1.287
Ashkali	38,7	71,7	49,0	19,5	49,3	10,5	3.464
Egjiptian	41,3	68,2	55,8	13,0	41,5	4,5	1.774
Shqiptar	33,0	66,6	47,2	23,2	49,1	13,7	480
Grupe tjera etnike	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	12
Mungon	(34,4)	(55,0)	(8,7)	(0,0)	(29,4)	(20,7)	23
Privimi material							
Tri ose më shumë	43,4	74,2	57,1	18,4	47,7	11,0	6.066
Dy	20,7	52,3	11,3	25,4	50,1	10,0	420
Asnjë ose një	11,7	30,6	14,2	20,6	43,9	10,2	553
Kuintilët e indeksit të pasurisë							
Më të varfërit	68,5	86,2	85,6	13,5	44,2	10,3	1.408
Të dytët	45,1	82,4	61,0	22,3	50,4	15,0	1.405
Mesatarët	38,1	76,5	56,5	18,8	49,4	8,1	1.410
Të katërtit	29,9	66,8	40,2	20,2	46,9	9,4	1.408
Më të pasurit	16,1	35,7	11,6	20,1	46,8	11,6	1.408
Indeksi i pasurisë							
Më të varfërit 60 përqind	50,6	81,7	67,7	18,2	48,0	11,1	4.223
Më të pasurit 40 përqind	23,0	51,2	25,9	20,2	46,8	10,5	2.816

¹ Treguesi MICS EQ.S5 – Zhurma

() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

SHTOJCA A. DIZAJNI I MOSTRËS

Në këtë shtojcë përshkruhen karakteristikat kryesore të mostrës. Karakteristikat e mostrës përfshijnë përcaktimin e kornizës së mostrës, madhësinë e synuar të mostrës, alokimin (ndarjen) e mostrës, renditjen në grupe të mostrave, zgjedhjen e fushave, fazat e mostrimit, shtresëzimin (stratifikimin) dhe llogaritjen e peshave të mostrave.

A.1 DIZAJNI I MOSTRËS PËR MICS 2019–2020 PËR KOSOVË

Objektivi kryesor i mostrës për MICS 2019–2020 për Kosovë ishte të gjeneronte vlerësime statistike të besueshme të shumicës së treguesve, në nivel kombëtar, për zonat urbane dhe ato rurale. Zonat urbane dhe rurale në secilin prej shtatë rajoneve: Gjakova, Gjilan, Mitrovica, Peja, Prizren, Prishtina dhe Ferizaj u përcaktuan si shtresa të mostrave. Në hartimin e mostrës për MICS 2019–2020 për Kosovë, ishte e dobishme të rishikohet mostra dhe rezultatet e MICS për Kosovë të kryer në 2013–2014, të dokumentuara në Raportin Përfundimtar të kësaj ankete.

Për zgjedhjen e mostrës së studimit u përdor një qasje dy-fazëshe e mostrimit të stratifikuar në grupim. Korniza e marrjes së mostrave u bazua në Regjistrimin e Popullsisë dhe Vendbanimeve të Kosovës në vitin 2011. Marrë parasysh që komunat veriore me shumicë të popullsisë serbe nuk ishin pjesë e kësaj kornize të mostrimit, në këtë ushtrim u morr parasysh korniza alternative e mostrave e vitit 2008. Prandaj, korniza e mostrimit për MICS 2019–2020 është kombinim i kornizës së mostrimit të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 dhe asaj alternative të vitit 2008. Në fazën e parë, njësia kryesore e marrjes së mostrave (NjKM) ishte 4.626 në qarqet regjistruese (QR) të përcaktuara për numërimin e regjistrimit të popullsisë. Në secilën mostër të fushës së numërimit u bë listimi i ekonomive familjare, dhe në fazën e dytë u përzgjedh mostra e ekonomive familjare.

A.1.1 MADHËSIA DHE ALOKIMI (NDARJA) E MOSTRËS

Meqenëse madhësia e përgjithshme e mostrës për MICS 2019–2020 për Kosovë pjesërisht varet nga fushat gjeografike të analizës që janë përcaktuar për tabelat e anketës, shpërndarja e QR-e dhe ekonomive familjare në Kosovë nga korniza e mostrimit të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 u shqyrtua së pari nga rajoni, shtresat rurale dhe urbane, të paraqitura në Tabelën SD.1.

Tabela SD.1: Shpërndarja e Qarqeve Regjistruese dhe ekonomive familjare në kornizën e mostrimit

Shpërndarja e Qarqeve Regjistruese dhe ekonomive familjare, sipas rajonit, shtresave urbane dhe rurale, Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 dhe korniza alternative e mostrimit të vitit 2008

	Numri i QR-ve			Numri i ekonomive familjare (Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 dhe korniza alternative e mostrimit të vitit 2008)		
	Totali	Urban	Rural	Totali	Urban	Rural
Totali	4.626	1.315	3.311	309.411	135.462	173.949
Rajoni						
Gjakova	461	123	338	31.416	11.879	19.537
Gjilan	540	125	415	33.082	13.139	19.943
Mitrovica	748	202	546	43.981	20.089	23.892
Peja	458	120	338	30.356	12.458	17.898
Prizren	732	196	536	52.436	20.172	32.264
Prishtina	1.208	428	780	87.045	46.133	40.912
Ferizaj	479	121	358	31.095	11.592	19.503

Madhësia e përgjithshme e mostrës për MICS 2019–2020 për Kosovë u llogarit si 6.480 ekonomi familjare. Për të vlerësuar madhësinë e nevojshme të mostrës për këtë tregues është përdorur formula në vijim:

$$n = \frac{[4(r)(1-r)(deff)]}{[(RME \times r)^2(pb)(AveSize)(RR)}$$

ku:

n = madhësia e nevojshme e mostrës, e shprehur si numri i ekonomive familjare

4 = një faktor për të arritur nivelin e besimit prej 95 përqind

r = vlera e anticipuar ose e parashikuar e treguesit, e shprehur në formën e një proporcioni

$deff$ = efekti i dizajnit për treguesin, vlerësuar nga MICS-i i mëparshëm

RME = marzhi relativ i gabimit të r që do të tolerohet në nivelin e 95 përqind të besimit

pb = përqindja e popullsisë së përgjithshme mbi të cilën bazohet treguesi, r

$AveSize$ = madhësia mesatare e ekonomisë familjare (numri mesatar i personave për ekonomi familjare)

RR = shkalla e parashikuar e përgjigjes

Tabela e madhësisë së mostrës u përdor për të vlerësuar kërkesat e madhësisë së mostrës për tregues të përzgjedhur, duke përfshirë në vijim: Pjesëmarrja e fëmijëve në punë (me një vlerësim prej 10 përqind, të vitit 2013, dhe madhësinë e llogaritur të mostrës prej 4.959 ekonomive familjare, 15 përqind RME (ang. Relative margin of error) për nivelin kombëtar); edukimin në fëmijëri të hershme (me një vlerësim prej 14 përqind, të vitit 2013 dhe madhësi të llogaritur të mostrës prej 8.322 ekonomive familjare, 15 përqind RME për nivelin kombëtar); dhe atyre që aktualisht përdorin ndonjë metodë kontraceptive në mesin e femrave të martuara/në bashkëjetesë, të moshës 15–49 vjeç (si provë e llogaritjes për regjionet, me një vlerësim prej 66 përqind, të vitit 2013, dhe një përllogaritje të madhësisë së mostrës prej 2.406 familjeve, 5 përqind RME për rajonin).

Siç mund të shihet nga llogaritjet e mëparshme, vlerësime të ndryshme të madhësisë së mostrës mund të merren kur treguesi bazë ndryshohet. Për më tepër, vlerësimet e madhësisë së mostrës në nivelin urban/rural gjithashtu japin alternativa të ndryshme. Pra, për të garantuar që kemi një numër të mjaftueshëm të vëzhgimeve për nën popullatën kryesore, siç janë femrat e moshës 15–49 vjeç, fëmijët e moshës 0–4 vjeç dhe fëmijët e moshës 12–23 muaj, janë kryer disa llogaritje të mëtejshme. Për shembull ka qenë e nevojshme dhe është planifikuar të kemi minimum rreth 200 fëmijë të moshës 12–23 muaj në secilin fushë.

Bazuar në llogaritjen e madhësisë së mostrës për tregues të ndryshëm dhe për të pasur një numër të mjaftueshëm vëzhgimesh për nën-grupet bazë, si dhe për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe burime të mjaftueshme, u propozua që të kishte një madhësi të mostrës prej 3.000 ekonomive familjare për zonat rurale dhe një madhësi të mostrës prej 3.380 për zonat urbane.

Numri i ekonomive familjare të zgjedhura për grupim për MICS 2019–2020 për Kosovë u përcaktua si 20 ekonomi familjare, bazuar në disa konsiderata, duke përfshirë efektin e dizajnit, buxhetin në dispozicion dhe kohën që do të duhej për ekipin që ta përfundojë një grupim. Duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare me numrin e ekonomive familjare mostër për grupim, është llogaritur që 324 mostra do të duhet të përzgjidhen në nivelin kombëtarë. Numër i përgjithshëm jo i barabartë i mostrave u ndanë në rajone, pasi rajoni i Prishtinës ka një madhësi maksimale të mostrës prej 1.880 ekonomive familjare dhe rajonet Ferizaj dhe Pejë kanë 640 ekonomi familjare secila si madhësi minimale të mostrës. Në secilin rajon, grupimet (njësitë kryesore të

mostrimit) u shpërndanë në shtresa urbane dhe rurale proporcionalisht me numrin e ekonomive familjare në kornizën e regjistrimit të popullsisë për secilën shtresë brenda këtij rajoni. Tabela SD.2 tregon shpërndarjen e qarqeve të mostrës dhe ekonomive familjare në shtresat e mostrimit.

Tabela SD.2: Alokimi i mostrës

Alokimi (shpërndarja) i grupimeve mostër (QR-të) dhe ekonomive familjare mostër në shtresat e mostrimit, 2019–2020
MICS në Kosovë

	Grupimet mostër			Ekonomitë familjare mostër		
	Totali	Urban	Rural	Totali	Urban	Rural
Totali	324	170	154	6.480	3.400	3.080
Rajoni						
Gjakova	34	16	18	360	320	680
Gjilan	34	16	18	360	320	680
Mitrovica	44	24	20	400	480	880
Peja	32	16	16	320	320	640
Prizren	54	26	28	560	520	1.080
Prishtina	94	58	36	720	1.160	1.880
Ferizaj	32	14	18	360	280	640

A.1.2 PËRZGJEDHJA E QARQEVE REGJISTRUESE (GRUPIME)

Qarqet regjistruese të popullsisë u zgjodhën nga secila prej shtresave të mostrave duke përdorur procedurat e mostrimit në proporcion me madhësinë sistematike (pps), bazuar në numrin e ekonomive familjare në secilën zonë të regjistrimit nga korniza e Regjistrimit 2011 (dhe nga korniza alternative e mostrës e vitit 2008). Faza e parë e mostrimit u krye në këtë mënyrë duke zgjedhur numrin e kërkuar të QR-ve të mostrës (specifikuar në Tabelën SD.2) nga secili prej shtatë rajoneve, veçmas për shtresat urbane dhe rurale.

A.1.3 AKTIVITETET E LISTIMIT

Përditësimi i ekonomive familjare ishte thelbësor, duke marrë parasysh që regjistrimi i fundit i ekonomive familjare u bë gjatë përgatitjes së Regjistrimit të Popullsisë 2011. Prandaj, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) vendosi t'i listojë ekonomitë familjare në secilën mostër të NJSP-së për të zgjedhur mostrën e ekonomive familjare të MICS.

ASK rekrutoi ekipet përgjegjëse për listim dhe punën në terren. Trajnimi për listim zgjati katër ditë, nga 27 deri më 30 maj 2019, në ambientet e ASK-së. Trajnimi u përbë nga aspektet teorike dhe praktike të operacionit të listimit. Pjesa e parë e trajnimit (1,5 ditë) u përqendrua në një hyrje në MICS në Kosovë, qëllimin e hartëzimit dhe operacionit të listimit të ekonomive familjare, përgjegjësitë e personelit për listim dhe procedurat e listimit. Gjatë pjesës së dytë (2,5 ditë) të trajnimit, u krye një pilot studim në grupe urbane dhe rurale në rajonin e Prishtinës. U zgjodhën tridhjetë e katër grupime për pilot studim, duke përfshirë 14 grupime rurale, 7 gjysmë-urbane dhe 14 grupime urbane që nuk ishin pjesë e mostrës kryesore të MICS.

Aktiviteti i listimit filloi më 31 maj 2019 dhe përfundoi në fund të shtatorit të vitit 2019. Pesëmbëdhjetë ekipe zhvilluan listimin e qarqeve të zgjedhura regjistruese. Secili ekip përbëhej nga një hartëzues dhe një listues të mbikëqyruar nga 5 mbikëqyrës. Koordinator i terrenit të MICS (ASK), GIS dhe Eksperti i Azhurnimit (ASK) dhe Eksperti i Mostrimit dhe Metodologu i MICS-it (ASK), Konsulenti për MICS i UNICEF-it dhe Zyrtari i Monitorimi dhe Vlerësimi i UNICEF-it monitoruan nga afër procesin në terren për të siguruar cilësinë e listimit. Pas përfundimit të aktivitetit të listimit, stafi i ASK-së përgjegjës për mostrimin dhe metodologjinë e anketës kreu një përzgjedhje të rastësishme të 20 ekonomive familjare në secilën zonë të zgjedhur të regjistrimit.

Për qëllim të operacionit të listimit të ekonomive familjare, u përditësua shablloni i formularit të listimit të MICS me informacione shtesë, siç është numri i regjistrimit i secilës strukturë në hartat e QR; përkatësia etnike e kryefamiljarit dhe numri i anëtarëve të ekonomisë familjare. Përditësimi i shablloneve u kërkua nga ASK në përgatitje të Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë në vitin 2021.

Katërmbëdhjetë QR me më shumë se 300 ekonomi familjare për secilën u konsideruan si shumë të mëdha për listim të plotë. Në mënyrë që të arrihet një cilësi e mirë dhe të zvogëlohet koha e kërkuar për procesin e listimit, vetëm një pjesë (segment) e zgjedhur rastësisht për secilin QR ishte subjekt i listimit pas një procesi të segmentimit. Kufijtë e segmenteve u përcaktuan në terren në përputhje me konfigurimin e hartës në secilin QR, duke ndarë QR-të në pjesë/segmente me madhësi afërsisht të barabarta (bazuar në numrin e vlerësuar të banesave). Për 14 QR të tilla të mëdha, u përzgjedh një segment rastësisht, dhe brenda kufijve të segmentit, u listuan të gjitha ekonomitë familjare të banuara. Gjatë operacionit të listimit, më pak se 20 ekonomi familjare u azhurnuan në 3 QR të mostrës në zonat rurale. Si mostër u përzgjedhën të gjitha ekonomitë familjare të listuara në këto 3 QR, duke e çuar madhësinë përfundimtare të mostrës në 6.457 ekonomi familjare.

A.1.4 PËRZGJEDHJA E EKONOMIVE FAMILJARE

Listat e ekonomive familjare u përgatitën nga ekipet listuese në terren për secilin qark regjistruar. Më pas, ekonomive familjare iu caktua numri sekuenial nga 1 në M_{hi} (numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në secilën zonë të regjistrimit) në ASK, ku përzgjedhja e 20 ekonomive familjare në secilën zonë të regjistrimit u krye duke përdorur procedurat e zgjedhjes sistematike të rastësishme. Shablloni në tabelën e MICS6 për përzgjedhjen sistematike të rastësishme të ekonomive familjare është përshtatur për këtë qëllim.¹⁴⁵

Gjatë përzgjedhjes së QR-ve për MICS 2019–2020 për Kosovë dhe MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, u përzgjedhën gjithsej 13 QR për të dy anketat, prandaj u tërhoq një mostër sistematike e 20 ekonomive familjare për secilën anketë nga ato QR.

Anketa gjithashtu përfshiu një pyetësor individual për meshkujt që duhej të administrohej në gjysmën e mostrës së ekonomive familjare. Modeli i përzgjedhjes së ekonomive familjare i MICS përfshin një opsion për të specifikuar përqindjen e ekonomive familjare që do të përzgjidhen për administrimin e Pyetësorit individual për meshkuj, dhe tabela automatikisht përzgjedhi nën-mostrën përkatëse të ekonomive familjare.¹⁴⁵ Të gjithë meshkujt e moshës 15 deri 49 vjeç në ekonomitë familjare të përzgjedhura kanë qenë të kualifikueshëm për intervistë.

MICS 2019–2020 për Kosovë gjithashtu përfshiu testimin e cilësisë së ujit për një nën-mostër të ekonomive familjare brenda secilit grupim të mostrave. Një nën-mostër prej 5 nga 20 ekonomi familjare të përzgjedhura u përzgjedh në secilin grupim të mostrave duke përdorur mostrimin sistematik të rastësishëm për kryerjen e testimit të cilësisë së ujit, si për ujin në ekonomi familjare ashtu edhe për ujin në burim. Shablloni i përzgjedhjes së ekonomisë ekonomia familjare MICS përfshin një mundësi për të specifikuar numrin e ekonomive familjare që do të përzgjidhen për testimin e cilësisë së ujit, dhe tabela përzgjedhi automatikisht nën-mostrën përkatëse të ekonomive familjare.¹⁴⁵ Për shkak të nevojës për të pasur të paktën një ekonomi familjare me një testim blanko të cilësisë së ujit në secilën grupim, kur ekonomia familjare e përzgjedhur fillimisht për testim blanko nuk u gjet ose nuk pranoi pjesëmarrjen në anketë, një ekonomi familjare tjetër nga katër të tjerat u përzgjedh rastësisht për testimin blanko.

¹⁴⁵ Në dispozicion këtu: "MICS6 TOOLS" Home – UNICEF MICS. E qasur më 31 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#survey-design>.

A.1.5 LLOGARITJA E PESHAVE TË MOSTRËS

Mostra e MICS 2019–2020 për Kosovë nuk është e vetë-peshuar. Në thelb, fraksione të ndryshme të mostrës u përdorën në secilin rajon pasi numri i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të popullsisë dallon sipas rajonit. Për këtë arsye, peshat e mostrës u llogaritën dhe u përdorën në analizat pasuese të të dhënave të anketës.

Komponenti kryesor i peshës është reciprociteti i fraksionit të mostrimit të përdorur në përzgjedhjen e numrit të ekonomive familjare mostër në atë shtresë të veçantë të mostrimit (h) dhe NjKM (i):

$$W_{hi} = \frac{1}{f_{hi}}$$

Termi f_{hi} , probabiliteti i mostrimit për modelin të i -të të NjKM në shtresën e h -të, është produkt i probabiliteteve të përzgjedhjes në çdo fazë në secilën shtresë të mostrimit:

$$f_{hi} = p_{1hi} \times p_{2hi} \times p_{3hi},$$

ku p_{shi} është probabiliteti i përzgjedhjes së njësisë së mostrimit në fazën s për mostrën e i -të të NjKM-së në shtresën e h -të të mostrimit. Bazuar në dizajnin e mostrës, këto probabilitete janë llogaritur si më poshtë:

$$p_{1hi} = \frac{n_h \times M_{hi}}{M_h},$$

n_h = numri i NjKM-ve të zgjedhura në shtresën h

M_{hi} = numri i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të popullsisë 2011 për mostrën e i -të të NjKM në shtresën h

M_h = numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 për shtresën h

p_{2hi} = proporcioni i NjKM-së e listuar në mostrën e i -të të NjKM-së në shtresën h (në rastin e NjKM-ve që ishin segmentuar); për NjKM-të e pa segmentuara, $p_{2hi} = 1$

$$p_{3hi} = \frac{20}{M'_{hi}}$$

M'_{hi} = numri i ekonomive familjare të azhurnuara në mostrën i -th të NjKM në shtresën h

Meqenëse numri i ekonomive familjare në secilën zonë të regjistrimit (NjKM) nga korniza e Regjistrimit të popullsisë 2011 e përdorur për përzgjedhjen e fazës së parë dhe numri i përditësuar i ekonomive familjare në QR nga listimi janë përgjithësisht të ndryshëm, probabilitetet e përgjithshme individuale të përzgjedhjes për ekonomitë familjare në secilin QR të mostrës (grupim) janë llogaritur.

Një komponent i fundit në llogaritjen e peshave të mostrës merr parasysh nivelin e mos përgjigjes për intervistat të ekonomive familjare dhe individuale. Rregullimi (përshtatja) për mos përgjigje të ekonomisë familjare në secilën shtresë është i barabartë me:

$$\frac{1}{RR_h}$$

ku RR_h është shkalla e përgjigjes për ekonomitë familjare mostër në shtresën h , e përkufizuar si proporcion i numrit të ekonomive familjare të intervistuar në shtresën h nga numri i ekonomive familjare të përzgjedhura që u gjetën të banuara gjatë punës në terren në shtresën h .

Ngjashëm me këtë, rregullimi (përshtatja) për mos përgjigje në nivelin individual (femra, meshkuj dhe fëmijë nën 5 vjeç) për secilën shtresë është e barabartë me:

$$\frac{1}{RR_{qh}}$$

ku RR_{qh} është shkalla e përgjigjes për pyetëtorët individualë në shtresën h , e përcaktuar si proporcioni i individëve të kualifikuar (femra, meshkuj dhe fëmijë nën 5 vjeç) në ekonomitë familjare mostër në shtresën h të cilët u intervistuan me sukses.

Pas përfundimit të punës në terren, nivelet e përgjigjes u llogaritën për secilën shtresë të mostrave. Këto janë përdorur për të rregulluar peshat e mostrës të llogaritura për secilën grup. Shkalla e përgjigjes në MICS 2019–2020 për Kosovë tregohet në Tabelën SR.1.1 në këtë raport.

Faktorët e rregullimit të mos përgjigjes për pyetëtorët individualë për femra dhe për fëmijë nën 5 vjeç u aplikuan në peshat e rregulluara të ekonomisë familjare. Numrat e femrave dhe fëmijëve nën 5 vjeç të kualifikuar u morën nga lista e anëtarëve të ekonomisë familjare në Pyetësin ekonomia familjare për ekonomitë familjare ku intervistat u realizuan.

Peshat për Pyetësin individual për meshkuj janë llogaritur në një mënyrë të ngjashme. Në këtë rast, numri i meshkujve të kualifikueshëm në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare në të gjithë mostrën e MICS të ekonomive familjare në shtresë u përdor si numëruer i faktorit të rregullimit të mos-përgjigjes, ndërsa numri i pyetësorëve të kompletuar për meshkujt në shtresë u mor nga nën-mostra 50 përqind e ekonomive familjare. Prandaj, ky faktor rregullimi përfshin një faktor të nënkuptuar të peshës të mostrave prej 2 përveç rregullimit për mos-përgjigje në Pyetësin individual për meshkuj.

Në rastin e Pyetësit për fëmijët e moshës 5–17, në secilën ekonomi familjare mostër, është përzgjedhur një fëmijë rastësisht nga të gjithë fëmijët në këtë grup të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare. Pësia e ekonomisë familjare për fëmijët e moshës 5–17 vjeç rregullohet së pari bazuar në shkallën e përgjigjes për këtë pyetësor në nivelin e shtresës. Pasi kjo peshë e rregulluar e ekonomisë familjare të jetë normalizuar siç përshkruhet më poshtë, ajo shumëzohet me numrin e fëmijëve të moshës 5–17 vjeç të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare. Prandaj, peshat për fëmijët individualë të moshës 5–17 vjeç do të ndryshojnë nga ekonomia familjare mostër. Ky peshim i të dhënave për fëmijët e moshës 5–17 vjeç zbatohet në programet e tabelave për tabelat përkatëse.

Për testimin e cilësisë së ujit (si në ekonomi familjare ashtu edhe në burim) u zgjedh një nën-mostër prej 5 ekonomive familjare nga 20 ekonomi familjare të MICS-it në secilin grupim të mostrave. Prandaj, pesha bazë (e pa rregulluar) e ekonomisë familjare do të shumëzohet me të kundërtën e kësaj norme të nën-mostërimit si më poshtë:

$$W_{wqhi} = \frac{1}{f_{hi}} \times \frac{20}{5} = \frac{4}{f_{hi}},$$

ku:

W_{wqhi} = pesha bazë për nën-mostërën e ekonomive familjare të zgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në mostrën i -th të QR në shtresën h

Meqenëse shkalla e përgjigjes mund të jetë e ndryshme për testimin e cilësisë së ujit për konsum në shtëpi dhe në burim, peshat bazë për secilën u rregulluan veçmas për mos-përgjigje në nivelin e shtresës si më poshtë:

$$W'_{wqhi} = W_{wqhi} \times \frac{m_{wqh}}{m'_{wqh}},$$

ku:

- W'_{wqhi} = pesha bazë për nën-mostrën e ekonomive familjare të përzgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në mostrën i -th të QR në shtresën h (veçmas për testimin e cilësisë së ujit në ekonomi familjare dhe në burim)
- m_{wqh} = numri i ekonomive familjare të vlefshme (të banuara) të zgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në shtresën h
- m'_{wqh} = numri i familjeve mostër me testimin e përfunduar të cilësisë së ujit në shtresën h (veçmas për testimin e cilësisë së ujit në ekonomi familjare dhe në burim)

Peshat e plota (të papërpunuara) të MICS 2019–2020 për Kosovë u llogaritën duke shumëzuar të kundërtën e probabiliteteve të përzgjedhjes me faktorin e rregullimit të mos përgjigjes për secilën shtresë. Këto pesha u standardizuan (ose u normalizuan), një qëllim i së cilës është të bëjë që shuma e peshuar e njësive të mostrës së intervistuar të jetë e barabartë me madhësinë totale të mostrës në nivelin kombëtar. Normalizimi arrihet duke pjesëtuar peshat e plota të mostrës (të rregulluara për mos-përgjigje) me mesataren e këtyre peshave në të gjitha ekonomitë familjare në nivelin kombëtar. Kjo kryhet duke shumëzuar peshat e mostrës me një faktor konstant të barabartë me numrin e papeshuar të ekonomive familjare në nivelin kombëtar të pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të peshuar të familjeve (duke përdorur peshat e plota të mostrës të rregulluara për mos-përgjigje). Një procedurë e ngjashme standardizimi u ndoq në marrjen e peshave të standardizuara për pyetësorët individual të femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën 5 vjeç dhe testimin e cilësisë së ujit. Peshat e rregulluara (të normalizuara) të ekonomive familjare varionin midis 0,259607 dhe 3,154782 në 324 qarqet regjistruese të mostrave (grupime).

Peshat e mostrës iu bashkëngjiten të gjitha grupeve të të dhënave dhe u kryen analizat duke peshuar të dhënat për ekonomitë familjare, femrat, meshkujt, fëmijët nën-5 vjeç, fëmijët e moshës 5–17 vjeç dhe testimin e cilësisë së ujit me këto pesha të mostrës.

A.2 DIZAJNI I MOSTRËS PËR MICS 2019–2020 PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

Objektivi primar i dizajnit të mostrës për MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ishte për të prodhuar vlerësime statistike të besueshme për shumicën e treguesve në nivel kombëtar dhe për zonat urbane dhe rurale. Mostra është e stratifikuar sipas qarqeve regjistruese (QR-ve) me më shumë se 50 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptian si QR të vetëzgjedhura, me probabilitet të përzgjedhjes prej 1 dhe me më pak se 50 ekonomi familjare. QR me më pak se 10 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë përjashtuar nga korniza. Për dizajnin e mostrës 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për MICS-në në Kosovë ka qenë i dobishëm rishikimi i dizajnit dhe rezultateve të mostrës së MICS për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, të kryer më 2013–2014, si dhe të dokumentuara në Raportin Përfundimtar të asaj ankete.

Për përzgjedhjen e mostrës së anketës është përdorur një qasje dy-fazëshe e mostrimit të stratifikuar në grupim. Korniza e mostrës së anketës është bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive familjare dhe Banesave në Kosovë të vitit 2011. Njësitë kryesore të mostrave (NjKM) të përzgjedhura në fazën e parë kanë qenë 80 QR-të e përcaktuara për regjistrimin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Është bërë listimi i ekonomive familjare për secilën mostër të QR-së, dhe për fazën e dytë është përzgjedhur një mostër e ekonomive familjare.

A.2.1 MADHËSIA DHE ALOKIMI I MOSTRËS

Madhësia e mostrës së MICS-it të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për Kosovë është kalkuluar të jetë rreth 1.420 ekonomi familjare. Është kërkuar një lloj i veçantë i kornizës së mostrimit për të mbuluar këtë nënpopullatë, ashtu siç është shpjeguar më poshtë:

Sipas Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës të vitit 2011, janë vetëm 6.308 ekonomi familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, ose rreth 2 përqind e të gjitha ekonomive familjare. Si ekonomi familjare e komuniteteve Rom, Ashkali apo Egjiptian definohet ekonomia e cila ka së paku një person të grupit etnik Romë, Ashkali apo Egjiptian. Për ta ekzaminuar shpërndarjen gjeografike të ekonomive familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, stafi i ASK-së ka nxjerrë në formë tabelare totalin e ekonomive familjare me së paku një person nga këto grupe etnike sipas QR. Në total 667 QR janë identifikuar me së paku një ekonomi familjare nga komunitetet Rom/Ashkali/Egjiptian, mirëpo rreth gjysma e tyre (338 QR) kanë vetëm një deri në tri ekonomi familjare të komuniteteve Rom, Ashkali apo Egjiptian. QR-të janë renditur në radhitje të kundërt të numrit të ekonomive familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Është konstatuar se 169 QR kanë 10 ose më shumë ekonomi familjare me Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe këto QR përbëjnë 75,7 përqind të të gjitha ekonomive familjare me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.

Është vendosur që do të ishte me kosto më efektive dhe më e përshtatshme nga ana analitike që MICS-i për popullatën e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kufizohet në QR me 10 apo më shumë ekonomi familjare me komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Katër QR kanë më shumë se 100 ekonomi familjare me komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe 18 QR tjera kanë në mes të 50 dhe 99 ekonomi familjare me persona të katër grupeve etnike. Janë 147 QR që kanë në mes të 10 dhe 49 ekonomi familjare me komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Një pjesë e popullatës së identifikuar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Regjistrimin e Popullsisë së Kosovës të vitit 2011 mund të jenë zhvendosur që nga ajo kohë, kjo duke pasur parasysh shkallën më të lartë të migrimit për këtë grup të popullatës, në gjetjen e më shumë mundësive në vende tjera brenda Kosovës apo në rajon. Prandaj, numri aktual i ekonomive familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në QR të mostrës do mund të dihej pas Azhurnimit të ri të ekonomive familjare për të identifikuar ata me së paku një pjesëtar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Për të ofruar nivel të duhur të saktësisë për treguesit kyç të shëndetit të nënës dhe fëmijëve për popullatën e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, rekomandohet që madhësia e mostrës të jetë rreth 1.400 ekonomi familjare për këto grupe etnike pasi që lëvizshmëria që nga MICS 2013–2014 mund të jetë më e lartë. Strategjia e mostrimit është e ngjashme me atë të përdorur për MICS 2019–2020 të Kosovës. Në fazën e parë, është përzgjedhur një mostër prej 80 QR me probabilitet proporcional ndaj madhësisë (PPM) nga korniza e QR me 10 apo më shumë ekonomi familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku madhësia bazohet në numrin e ekonomive familjare me persona të këtyre grupeve etnike brenda kornizës. Pas azhurnimit të ri për identifikimin e ekonomive familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në QR të mostrës, 20 nga këto ekonomi familjare janë përzgjedhur nga secili QR në fazën e dytë të mostrimit. Për QR-të me më pak se 20 ekonomi familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për intervistim do të përzgjidheshin të gjitha ekonomitë familjare. Me një mostër prej 80 QR të përzgjedhura në fazën e parë, mostra finale do të ishte rreth 1.420 ekonomi familjare.

Bazuar në përzgjedhjen e 80 QR të mostrës me PPM, QR me 50 apo më shumë ekonomi familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë përzgjedhur në mostër me probabilitet 1. Përderisa janë 22 QR të përzgjedhura me siguri në kornizë, një mostër me 58 QR shtesë është përzgjedhur nga pjesa e mbetur e kornizës me PPM. Procedurat e fazës së parë dhe të dytë kanë qenë të ngjashme me ato të përshkruara në Seksionin A.1 për MICS 2019–2020 të Kosovës.

A.2.2 AKTIVITETET E LISTIMIT

Përderisa korniza e mostrimit (nga Regjistrimi i popullsisë të vitit 2011) nuk ishte e azhurnuar, një listim i ri i ekonomive familjare është realizuar në të gjitha qarqet regjistruese (QR) të mostrës para përzgjedhjes së ekonomive familjare. Për këtë qëllim, u formuan ekipet e listimit të cilat i vizituan qarqet regjistruese dhe i listuan të gjitha ekonomitë familjare në qarqet regjistruese. Ata po ashtu pyetën nëse në ekonomitë familjare jeton dikush nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për ta përcaktuar numrin total, nga i cili 20 ekonomi familjare do të duhej të përzgjidheshin me metodën e rastësishme. Në maj të vitit 2019 është mbajtur një trajnim i veçantë 4-ditorë mbi listimin, përfshirë një pilotim në zonat urbane dhe rurale sipas procedurave të rekomanduara të MICS-it. Një numër prej 5 mbikëqyrësish, 15 regjistruesish dhe 15 personash që bëjnë hartëzimin u përfshinë në aktivitetet e azhurnimit për t'i mbuluar 80 QR gjatë periudhës maj-shtator të vitit 2019. Shih gjithashtu Seksionin A.1.3 të kësaj Shtojce për më shumë informacione rreth operacionit të listimit.

Dy QR-të me më shumë se 300 ekonomi familjare ishin shumë të mëdha për listim të plotë. Në mënyrë që të arrihet një cilësi e mirë dhe të zvogëlohet koha e kërkuar për procesin e listimit, vetëm një pjesë (segment) e përzgjedhur me metodën e rastit të QR-së i ishte nënshtruar listimit pas procesit të segmentimit. Kufijtë e segmenteve u përcaktuan në terren në përputhje me konfigurimin e hartës për secilin QR, duke ndarë QR-të në pjesë/segmente me madhësi afërsisht të barabarta (bazuar në numrin e vlerësuar të banesave). Për 2 QR të tilla të mëdha, u përzgjodh një segment me metodën e rastit, dhe brenda kufijve të segmentit, u listuan të gjitha banesat e banuara me ekonomi familjare. Një nga dy QR-të u zgjodh për të dy mostrat (mostra 2019–2020 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë dhe mostra 2019–2020 për Kosovë), kështu që numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në grupim para segmentimit nuk ishte i ditur. Gjatë punës së listimit, 1 QR i mostrës së përzgjedhur nuk kishte ekonomi familjare me komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa 25 QR kishin më pak se 20 ekonomi familjare (14 QR në zonat urbane dhe 11 QR në zonat rurale). Të gjitha ekonomitë familjare të listuara në këto 25 QR u përzgjedhën për mostër, duke e çuar madhësinë përfundimtare të mostrës në 1.419 ekonomi familjare.

A.2.3 PËRZGJEDHJA E EKONOMIVE FAMILJARE

Listat e ekonomive familjare janë përgatitur nga ekipet e listimit në terren për secilin qark regjistruar. Ekonomive familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian pastaj iu është caktuar numri sequencial nga 1 deri në M_{hi} (numri total i ekonomive familjare në secilin qark regjistruar) tek ASK, ku është bërë përzgjedhja e 20 ekonomive familjare në secilin qark regjistruar duke përdorur procedurat për përzgjedhjen sistematike në mënyrë të rastësishme. Nëse ishin më pak se 20 ekonomi familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të listuara në një QR të caktuar të mostrës, të gjithat përzgjedheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe prandaj kemi grupime me më pak se 20 ekonomi familjare të mostrës. Tabela e MICS6, që është përdorur si shabllon për përzgjedhjen sistematike të rastësishme të ekonomive familjare, është përshtatur për këtë qëllim.¹⁴⁶

Gjatë përzgjedhjes së QR për MICS 2019–2020 për Kosovë dhe për MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, një total prej 13 QR-ve janë përzgjedhur për të dyja anketat, prandaj një mostër e ndarë sistematike e 20 ekonomive familjare është përzgjedhur për secilën anketë nga këto QR.

Anketa po ashtu ka përfshirë një pyetësor individual për meshkuj i cili do të duhej të administrohej në njërën gjysmë të mostrës së ekonomive familjare. Modeli MICS i përzgjedhjes së ekonomive familjare përfshin një opsion për të specifikuar përqindjen e ekonomive familjare që do të përzgjidhen për administrimin e Pyetësorit individual për meshkuj, dhe tabela ka përzgjedhur automatikisht nën-mostrën përkatëse të ekonomive familjare.¹⁴⁶ Të gjithë meshkujt e moshës 15 deri 49 vjeç në ekonomitë familjare të përzgjedhura kanë qenë të kualifikueshëm për intervistë.

MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë gjithashtu ka përfshirë testimin e cilësisë së ujit për një nën-mostër të ekonomive familjare brenda secilit grupim të mostrave. Nën-mostra prej 5 nga 20 ekonomi familjare të përzgjedhura është zgjedhur në secilin grupim të mostrave duke përdorur mostrimin sistematik të rastësishëm për kryerjen e testimit të cilësisë së ujit, si për ujin në ekonomi familjare ashtu edhe për ujin e burimit. Shablloni i MICS i përzgjedhjes së ekonomive familjare përfshin një opsion për të specifikuar numrin e ekonomive familjare që do të përzgjidhen për testimin e cilësisë së ujit dhe tabela automatikisht ka përzgjedhur nën-mostrën përkatëse të ekonomive familjare.¹⁴⁶ Për shkak të nevojës për të pasur të paktën një ekonomi familjare me një testim bllanko të cilësisë së ujit për secilin grupim, kur ekonomia familjare e përzgjedhur fillimisht për test bllanko nuk është gjetur ose ka refuzuar pjesëmarrjen në anketë, një ekonomi familjare tjetër nga katër të tjerat është përzgjedhur rastësisht për testimin bllanko.

A.2.4 LLOGARITJA E PESHAVE TË MOSTRËS

Mostra e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të MICS-it 2019–2020 në Kosovë nuk është e vetë-peshuar. Për këtë arsye, janë kalkuluar mostra të peshave të cilat janë përdorur në analizat pasuese të të dhënave të anketës.

Komponenti kryesor i peshës është reciprociteti i fraksionit të mostrimit të përdorur në përzgjedhjen e numrit të ekonomive familjare mostër në atë shtresë të veçantë të mostrimit (h) dhe NjKM (i):

$$W_{hi} = \frac{1}{f_{hi}}$$

¹⁴⁶ Në dispozicion këtu: "MICS6 TOOLS" Home – UNICEF MICS. E qasshme nga data 31 gusht 2018. <http://mics.unicef.org/tools#survey-design>.

Termi f_{hi} , probabiliteti i mostrimit për modelin të i -të të NjKM në shtresën e h -të, është produkt i probabiliteteve të përzgjedhjes në çdo fazë në secilën shtresë të mostrimit:

$$f_{hi} = p_{1hi} \times p_{2hi} \times p_{3hi},$$

ku p_{shi} është probabiliteti i përzgjedhjes së njësisë së mostrës në fazën s për i -tën mostër të NjKM në shtresën e h -të të mostrës. Bazuar në dizajnin e mostrës, këto probabilitete janë kalkuluar si vijon:

$$p_{1hi} = \frac{n_h \times M_{hi}}{M_h}, \text{ , kjo vlerë është 1 për 22 NjKM-të e vetë-zgjedhura, të përzgjedhura me probabilitet 1}$$

$n_h =$ numri i NjKM-ve mostër të përzgjedhura në shtresën h

$M_{hi} =$ numri i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 për mostrën e i -të të NjKM për shtresën e h -të

$M_h =$ numri total i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 për shtresën h

$p_{2hi} =$ përqindja e NjKM së listuar në mostrën ei -të NjKM në shtresën h (në rastin e NjKM-ve të cilat janë segmentuar); për NjKM-të e pa segmentuara, $p_{2hi} = 1$

$$p_{3hi} = \frac{20}{M'_{hi}}, \text{ , (numri i ekonomive familjare në grupim mund të jetë më i vogël se 20 nëse numri total i ekonomive familjare me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian është më i vogël se 20)}$$

$M'_{hi} =$ numri i ekonomive familjare të listuara në mostrën i -të NjKM në shtresën h

Nëse NjKM është e vetë-përfaqësuar (p.sh. me më shumë se 50 ekonomi familjare nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian) atëherë faza e parë e probabilitetit të përzgjedhjes (p_{1hi}) është e barabartë me 1. Në rastet kur 20 ose më pak ekonomi familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë listuar në NjKM të përzgjedhur, edhe faza e dytë e probabilitetit të përzgjedhjes (p_{3hi}) është e barabartë me 1.

Përderisa numri i ekonomive familjare të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në secilin qark regjistruar (QR) nga korniza e Regjistrimit të Popullsisë së vitit 2011 të përdorur për fazën e parë të përzgjedhjes dhe numri i azhurnuar i ekonomive familjare të kualifikueshme nga qarqet regjistruese të përfshira në listim janë përgjithësisht të ndryshme, janë kalkuluar probabilitetet individuale të përgjithshme të përzgjedhjes për ekonomitë familjare në secilin qark regjistruar të mostrës (grupim).

Komponenti i fundit i kalkulimit të peshave të mostrës merr parasysh nivelin e mos-përgjigjes së ndonjë ekonomie familjare dhe intervistave individuale. Rregullimi (përshtatja) për mos-përgjigjet e ekonomisë familjare në secilën shtresë është i barabartë me:

$$\frac{1}{RR_h}$$

nëse RR_h është shkalla e përgjigjes për mostrën e ekonomive familjare në shtresën h , e definuar si proporcioni i numrit të ekonomive familjare të intervistuar në shtresën h nga numri i ekonomive familjare të përzgjedhura që janë gjetur si të banuara gjatë punës në terren në shtresën h .

Ngjashëm me këtë, rregullimi për mos-përgjigje në nivelin individual (femra, meshkuj dhe fëmijë nën moshën 5 vjeçare) për secilën shtresë është i barabartë me:

$$\frac{1}{RR_{qh}}$$

nëse RR_{qh} është shkalla e përgjigjes në pyetësorët individual në shtresën h , e definuar si proporcioni i individëve të kualifikuar (femra, meshkuj dhe fëmijë nën moshën 5 vjeçare) në mostrën e ekonomive familjare në shtresën h të cilët janë intervistuar me sukses.

Pas përfundimit të punës në terren, shkalla e përgjigjes është kalkuluar për secilën shtresë të mostrës. Këto janë përdorur për t'i përshtatur peshat e mostrës së kalkuluar për secilin qark regjistruar. Shkallët e pjesëmarrjes për MICS 2019–2020 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë paraqitur në Tabelën SR.1.1R të këtij raporti.

Faktorët e rregullimit të mos-përgjigjes për pyetësorët individualë për femra dhe fëmijë nën moshën 5 vjeçare janë aplikuar për t'i përshtatur peshat e ekonomive familjare. Numri i femrave dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare të kualifikueshëm janë marrë nga regjistri i anëtarëve të ekonomive familjare në Pyetësorin e ekonomisë familjare për ato ekonomi familjare ku janë përfunduar intervistat.

Peshat për Pyetësorin individual për meshkuj janë llogaritur në mënyrë të ngjashme. Në këtë rast, numri i meshkujve të kualifikueshëm në listën e anëtarëve të ekonomive familjare në të gjitha ekonomitë familjare mostër të MICS në shtresë janë përdorur si numërues i faktorit të rregullimit të mos-përgjigjes, ndërsa numri i pyetësorëve të plotësuar për meshkujt në shtresë është nxjerrë nga nën-mostra prej 50 përqind të ekonomive familjare. Prandaj, ky faktor rregullimi përfshin një faktor peshimit të nën-mostrës prej 2, përveç rregullimit për mos-përgjigje në Pyetësorin individual për meshkuj.

Në rastin e Pyetësorit për fëmijët e moshës 5–17 vjeç, në secilën ekonomi familjare të mostrës, është përzgjedhur një fëmijë me metodën e rastit nga të gjithë fëmijët e kësaj grupmoshë të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare. Pësia e ekonomisë familjare për fëmijët e moshës 5–17 vjeç rregullohet së pari bazuar në shkallën e përgjigjes ndaj këtij pyetësori në nivelin e shtresës. Pasi që kjo peshë e rregulluar e ekonomisë familjare të jetë normalizuar siç përshkruhet më poshtë, ajo shumëzohet me numrin e fëmijëve të moshës 5–17 vjeç të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare. Prandaj, peshat për fëmijët individualë të moshës 5–17 vjeç do të ndryshojnë nga ekonomia familjare mostër. Ky peshim i të dhënave për fëmijët e moshës 5–17 vjeç zbatohet në programet e tabelimit për tabelat përkatëse.

Për testimin e cilësisë së ujit (si në ekonomi familjare ashtu edhe në burim) është përzgjedhur nën-mostra prej 5 ekonomive familjare nga 20 ekonomitë familjare mostër të MICS në secilën grupim të mostrave. Prandaj, pësia bazë (e pa rregulluar) e ekonomisë familjare do të shumëzohet me të kundërtën e kësaj shkalle të nën-mostrës si më poshtë:

$$W_{wqhi} = \frac{1}{f_{hi}} \times \frac{20}{5} = \frac{4}{f_{hi}},$$

ku:

W_{wqhi} = pësia bazë për nën-mostrën e ekonomive familjare të përzgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në mostrën e i -të të QR në shtresën h

Meqenëse shkalla e përgjigjes mund të jetë e ndryshme për testimin e cilësisë së ujit për konsum shtëpiak dhe në burim, peshat bazë për secilën prej tyre janë rregulluar veçmas për mos-përgjigje në nivelin e shtresës si në vijim:

$$W'_{wqhi} = W_{wqhi} \times \frac{m_{wqh}}{m'_{wqh}},$$

ku:

W'_{wqhi} = pesha e rregulluar për nën-mostrën e ekonomive familjare të përzgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në mostrën e i -të të QR në shtresën e h -të (ndaras për testimin e cilësisë së ujit në ekonomi familjare dhe në burim)

m_{wqh} = numri i ekonomive familjare të mostrave të vlefshme (të banuara), të përzgjedhura për testimin e cilësisë së ujit në shtresën h

m'_{wqh} = numri i ekonomive familjare të mostrës ku është kryer testimi i cilësisë së ujit në shtresën h (ndaras për testimin e cilësisë së ujit në ekonomi familjare dhe në burim)

